

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5778
E enjte, 16 maj 2019
çmimi 0.40 €

Kur është i mundur liberalizimi i vizave për Kosovën? IFAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", HYSNI GUCATI IFAQE 4-5

Themelimi i tribunalit për krimet serbe të bëhet përmes ligjit

Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL-UÇK), Hysni Gucati, ka vlerësuar se institucionet shtetërore janë vonuar sa i përket themelimit të tribunalit për krimet serbe në Kosovë. Ai ka thënë se themelimi i këtij tribunal duhet të bëhet përmes ligjit dhe jo përmes rezolutës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gucati u ka bërë thirrje ambasadave të vendeve të Quintit që ta mbështesin Kosovën në këtë rrugëtim. Ai ka thënë se ka ardhur koha që Serbia të ndëshkohet për të gjitha krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë. Sipas Gucatit, nuk do të mund të ketë pajtim ndërmjet dy vendeve përderisa Serbia nuk kërkon falje për krimet dhe gjenocidin e kryer në Kosovë



AKTUALE

SHKATËRRUESIT E ATDHEUT DHE DHUNESIT E MËMËDHEUT! F.11

Shkruan:
Behxhet Sh. SHALA
- BAJGORA



MULTIKULTURALIZIMI NGA PARLAMENTI MAQEDONAS, NJË LEKSION PËR ALEKSANDËR VUÇIQIN? F.8

Salihe SALIHU -
PhD kandidat



Thaçi kërkon që vendet e Quintit të jenë unike për Kosovën



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, e ka ftuar për unitet faktorin ndërkombëtar për Kosovën në dialogun me Serbinë. Në takim me ambasadorët dhe shefat e zryrave dhe të misioneve ndërkombëtare në Prishtinë ai ka thënë se kur ka funksionuar ky unitet skena politike në Kosovë ka qenë unike dhe e gatshme për të lëvizur përpara. Në këtë takim Thaçi ka shprehur zhgënjimin e tij se si në takimin e Berlinit nuk ka pasur unitet nga vendet e Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës

KQZ-ja AKREDITOI 464 VËZHgues PËR ZGJEDHJET NË KOMUNAT E VERIUT F.7

EKONOMI

GJERMANIA MBËSHKET KOSOVËN ME DY MILIONË EURO PËR QEVERISJEN E MIRË FINANCIARE F.9

MBI 20 MILIONË EURO VETËM PËR KËSHILLTARË TË PROJEKTIT 'KOSOVA E RE' F.9

SPORT

MBI 20 MILIONË EURO VETËM PËR KËSHILLTARË TË PROJEKTIT 'KOSOVA E RE' F.12



Nënshkruhet marrëveshja për menaxhimin e spitaleve sipas praktikave ndërkombëtare IFAQE 5



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666


Putini mund të takohet me Trumpin muajin e ardhshëm

MOSKË, 15 MAJ - Presidenti rus Vladimir Putin ka thënë se ai mund të takohet me presidentin amerikan Donald Trump në margjinat të samitit të 20 vendeve më të industrializuara (G20), muajin e ardhshëm në Japoni. Trumpi ka thënë më 14 maj se ai ka planifikuar të takohet me Putinin në atë samit. Duke folur në një konferencë

të përbashkët më 15 maj në Soçi, bashkë me presidentin e Austrisë, Alexander Van der Bellen, Putini ka thënë se Rusia është plotësisht e gatshme për t'i normalizuar marrëdhëniet me Uashingtonin në momentin që kushtet në politikën e brendshme të Shteteve të Bashkuara lejojnë një gjë të tillë. "Ne jemi të hapur për t'i përmirësuar marrëdhëniet,

mirëpo nuk ka të bëjë me ne. Ka të bëjë me bashkëpunëtorët amerikanë", tha ai. "Sapo ata të jenë gati për këtë, dhe sapo të ndryshojë situata e tyre e brendshme politike, ne jemi të gatshëm", ka thënë Putini. "Shpresoj që këto kushte do të krijohen gradualisht në mes të Moskës dhe Uashingtonit, sidomos pasi raporti i këshilltarit special, Robert Mueller, ka

konfirmuar se nuk ka pasur bashkëpunim dhe Rusia nuk ka ndërhyrë kurrë në zgjedhjet amerikane", tha presidenti rus. Një ditë më parë Putini i ka thënë sekretarit amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, se ai shpreson t'i "rikthejë" lidhjet mes Moskës dhe Uashingtonit dhe beson se Trumpi dëshiron të njëjtën gjë.



Komisioni hetimor për dëbimin e shtetasve turq përfundoi raportin

Komisioni parlamentar që po heton operacionin e dëbimit të gjashtë shtetasve turq miratoi të mërkurën projektraportin mbi operacionin duke konstatuar dhjetëra shkelje nga institucionet e vendit dhe bëri thirrje që çështja të trajtohet nga Prokuroria e Posaçme e Kosovës

PRISHTINË, 15 MAJ - Komisioni parlamentar që po heton operacionin e dëbimit të gjashtë shtetasve turq, një vit më parë, miratoi të mërkurën projektraportin mbi operacionin dhe bëri thirrje që çështja të trajtohet nga Prokuroria e Posaçme e Kosovës. Kryesuesi i këtij komisioni, Xhelal Sveçla, tha se komisioni ka konstatuar dhjetëra shkelje nga institucionet e vendit ndërsa, sipas tij, urdhrin për dëbimin e gjashtë shtetasve turq e ka dhënë presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka raportuar vova. "Mund të them lirisht se janë mbi 31 shkelje, por të faktuara nga dy e më shumë burime janë 31 shkelje të cilat janë evidentuar nga komisioni. Pak a shumë duke marrë parasysh edhe sjelljen e presidentit dhe reagimet si të tij, si të njerëzve përreth tij, tashmë është bërë e qartë se urdhërdhënës për këtë që ka ndodhur është vetë presidenti Hashim Thaçi, i cili në mënyrë jashtëzakonisht të papërshtatshme dhe arrogante parandaloj raportimin para komisionit", tha ai. Muajin e kaluar në këtë komision ishte thirrur të raportojë presidenti Thaçi, por paraqitja e

tij ishte përshkruar me përplasje të ashpra dhe akuza të ndërsjella, duke çuar edhe në dështimin e seancës dëgjimore. Presidenti Thaçi kërkoi në atë takim hetim ligjor për ekspertin ndërkombëtar që ka hartuar raportin mbi dëbimin e shtetasve turq. Presidenti Thaçi hodhi kërkesën që të hetohet edhe vetë komisioni pasi që, sipas tij, ka bërë shkelje ligjore me punësimin e ekspertit ndërkombëtar duke vlerësuar se ai ka qenë i njëanshëm. Por, anëtari i këtij komisioni, Driton Selmanaj, tha të mërkurën se e gjitha kjo ishte përpjekje e presidentit për ta penguar punën e tyre. "Mbi 51 profesorë të Harvardit dhe të shumë universiteteve amerikane na kanë dërguar letra ne në mbrojtje të ekspertit. Por, ky skenar i tyre shihet qartazi që është tendencë për ta penguar dhe denigruar përfundimin e kësaj pune. Por ne jemi të bindur dhe tashmë e dëshmuam që kur ekziston vullneti maksimal i politikanëve dhe i kujtdo qoftë, nuk ka person as faktor që mund ta ndalë një proces, në mënyrë që të zbardhet e vërteta, e gjitha kjo në funksion të vetëm një gjëje: që Kosova të



jetë shtet i së drejtës", tha ai. Raporti përfundimtar i komisionit do të hidhet për diskutim në Kuvendin e Kosovës, tha Sveçla, ndërsa i bëri thirrje prokurorisë që të trajtojë seriozisht këtë çështje. "Unë mendoj se shkelja më e rëndë është shkelja me vetëdije e institucioneve kryesore të udhëhequra nga presidenti i Kosovës, të të drejtave të njeriut, të ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës, por edhe të konventave ndërkombëtare, të cilat edhe vetë sipas Kushtetutës i mbivendosen Kushtetutës së Kosovës. Është faktuar se me vetëdije të plotë janë bërë këto shkelje, motivet ne pak a shumë mund t'i supo-

zojmë dhe besoj se prokuroria duhet t'i thërrasë të gjithë këta bartës të institucioneve veç e veç për ta dhënë dëshminë e tyre dhe në bazë të këtyre gjetjeve si dhe gjetjeve të mëtutjeshme të prokurorisë, të ngritën aktakuzat e para", tha Sveçla. Më 29 mars të vitit 2018 autoritetet në Kosovë arrestuan gjashtë shtetas turq, punonjës të institucioneve në pronësi të klerikut turk Fethullah Gulen, të cilin presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan e fajëson për një përpjekje për grusht shteti në Turqi. Të gjashtët iu dorëzuan autoriteteve turke në një operacion që la pas vetes shumë paqartësi, shumë kritika ndaj

institucioneve dhe nxitë një përplasje deklarata ndërmjet presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan dhe kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj. Komision parlamentar për hetimin e operacionit, që u themelua në korrik të vitit të kaluar, kishte pohuar edhe më herët se shkeljet më të mëdha janë bërë nga Agjencia e Zbulimit dhe Ministria e Punëve të Brendshme. Këto gjetje nxitën edhe reagimin e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, e cila kishte tërhequr vërejtjen se "trysnia politike mbi sektorin e sigurisë është shkelje skandaloze e vlerave demokratike".

Zaev: Riformatimi i qeverisë, deri në qershor

SHKUP, 15 MAJ - Kryeministri i Maqedonisë Veriore, Zoran Zaev, bëri me dije se, përveç ndryshimeve në kabinetin qeveritar, do të ketë ndryshim edhe të strukturave drejtuese në institucionet e tjera që janë në kompetencë të Qeverisë dhe në LSDM. "Besoj se në fillim të qershorit do të dal me ndryshimet komplete

në strukturat udhëheqëse në nivel të ministrave dhe institucioneve shtetërore. Po ashtu, besoj se kah fundi i qershorit do të lëshohemi edhe në vertikale në komunat ku shteti përfaqësohet me institucionet e tij. Paralelisht me këtë, unë si kryetar i LSDM-së duhet të bëj disa ndryshime në partinë time politike sepse një

pjesë e reflektimit të qytetarëve vjen nga partia e parë në pushtet", tha Zaev. Që nga paralajmërimi i së ashtuquajturës "fshesa e kryeministrit", shumë nga ministrat janë prononcuar se nuk besojnë që do të jenë target i ndryshimeve, por vendimin përfundimtar e lënë në dorë të liderëve Zaev dhe Ahmeti.



Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka takuar ambasadorët dhe shefat e zyrave dhe misionëve ndërkombëtare në Kosovë

Thaçi kërkon që vendet e Quintit të jenë unike për Kosovën

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka ftuar për unitet faktorin ndërkombëtar për Kosovën në procesin e dialogut me Serbinë. Në takim me ambasadorët dhe shefat e zyrave dhe misionëve ndërkombëtare në Prishtinë ai ka thënë se kur ka funksionuar ky unitet edhe skena politike në Kosovë ka qenë unike dhe e gatshme për të lëvizur përpara. Në këtë takim, Thaçi ka shprehur zhgënjimin e tij se si në takimin e Berlinit nuk ka pasur unitet në vendet e Bashkimit Evropian rreth liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës



**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 15 MAJ - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka kërkuar unitet të faktorit ndërkombëtar për Kosovën në procesin e dialogut me Serbinë. Në takim me ambasadorët dhe shefat e zyrave dhe misionëve ndërkombëtare në Kosovë, të cilin e kishte ftuar për t'i ndarë me ta opinionet nga takimi i Berlinit dhe pritjet për takimin që do të mbahet në Paris, Thaçi ka theksuar rëndësinë që shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, shtetet perëndimore në përgjithësi, të jenë më unike dhe më të qarta në këtë proces. "Përvoja e së kaluarës së afërt tregon se kur ka funksionuar ky unitet edhe skena politike në Kosovë ka qenë unike dhe e gatshme për të lëvizur përpara", ka thënë presidenti Thaçi. Para ambasadorëve dhe shefave të misionëve, presidenti Thaçi ka bërë me dije se ishte i befasuar për të keq kur ka mësuar që për takimin e Berlinit nuk kishte koordinim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Shpresoj se takimi në Paris do të jetë më mirë i përgatitur, se

vendet anëtare të BE-së do të jenë më unike, do të prezantojnë ide kreative si të lëvizet përpara dhe takimi do të ketë substancë", është shprehur Thaçi. Duke folur për pjesëmarrjen e Kosovës në takimin e ftuar për 1 korrik në Paris, presidenti u shpreh se Kosova në këtë takim do të jetë unike dhe do të përfaqësohet nga liderët e institucioneve, nga Delegacioni Shtetëror për Dialogun dhe se platformë e delegacionit kosovar në këtë takim do të jetë rezoluta e Kuvendit të Kosovës. Ai është shprehur kundër kërkesave të Serbisë për këtë proces, duke thënë se nuk do të lejohet që dialogu të kushtëzohet nga Serbia. Sipas Thaçit, taksa kundër prodhimeve të Serbisë do të mbetet në fuqi. Presidenti ka thënë se ka mirëpritur kthimin e vëmendjes së Gjermanisë dhe Francës në çështjet e Ballkanit Perëndimor, në veçanti në procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Vlerësoj lart vullnetin e mirë të kancelares Merkel dhe këmbëngulësinë e presidentit Macron që çështjet e Ballkanit Perëndimor të lëvizin përpara", ka deklaruar Thaçi.

Për takimin e Berlinit, ai ka deklaruar se ky samit as nuk mbylli dhe as nuk hapi ndonjë ide apo koncept për mundësinë e arritjes së marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi. Për të njëjtin qëllim edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka pritur të mërkurën ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt. "Takim i rregullt me ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, me të cilin biseduam për takimin e Berlinit, pritjet nga takimi i Parisit dhe rolin konstruktiv dhe konsistent të Gjermanisë karshi Kosovës, ruajtjes së integritetit territorial të vendit dhe stabilitetin në rajon. E falënderova ambasadorin Heldt për mbështetjen e vazhdueshme politike dhe financiare për proceset e rëndësishme të qeverisjes në vend dhe kërkova që kjo mbështetje të vazhdojë, siç shpreha përkushtimin tonë për ta çuar përpara agjendën bilaterale mes dyja vendeve", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Nga Samiti i Parisit pritjet qartësi e procesit

Njohësit e rrethanave politike në vend dhe zyrtarët e lartë qeveritarë presin që Samiti i Berlinit ta qartësojë procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Ish-ambasadori i Kosovës në Austri dhe Australi, Sabri Kiçmari, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se takimi i Parisit, i cili do të mbahet më 1 korrik, do të jetë më konkret. "Samiti i Parisit pritjet të jetë më konkret. Në të do të debatohet për hapat drejt zgjidhjes. Mund të supozojmë një ashpërsi të gjuhës, të asaj që në diplomaci quhet si vënia para shkopit dhe karotës: nëse pranoni këtë veprim, do të keni këto përfitime; në rast refuzimi, do t'i keni këto pasoja. Megjithatë, është ende herët të flitet për detajet. Shumica do të qartësohet në javët që vijnë", ka thënë Kiçmari. Profesori universitar ka thënë se të dyja palët nga Samiti i Berlinit kanë marrë mesazhe të qarta.

"Në Samitin e Berlinit të dyja palët kanë marrë mesazhin e rëndësishëm që ka pajtimi dhe gjetja e një marrëveshjeje në mes të dy vendeve për të ardhmen e tyre në BE. Kancelarja Merkel dhe presidenti Macron ua kanë ofruar palëve përvojën gjermano-franceze dhe, bazuar në këtë përvojë, u munduan t'i joshin me përfitimet që ka për Kosovën, Serbinë dhe vendet e rajonit nga një marrëveshje eventuale në mes të dy vendeve", ka thënë Kiçmari. Të njëjtat pritje nga samiti i ardhshëm i ka edhe zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj. "Ne presim që në Samitin e Parisit të ketë qëllime të qarta, parametra për vazhdimin e dialogut shumë më të qarta dhe pritjet që kanë të bëjnë me zbatimin e marrëveshjeve të jenë më të qarta, meqë takimi në Paris është bilateral Kosovë - Serbi, natyrisht me pjesëmarrje të Francës dhe Gjermanisë dhe institucioneve të tjera të BE-së", ka thënë Hoxhaj për gazetën "Epoka e re".

Hoxhaj: Viti 2019, një mundësi e madhe për ta arritur marrëveshjen me Serbinë

PRISHTINË, 15 MAJ (ER) - "Viti 2019 është një mundësi e madhe për ta arritur marrëveshjen me Serbinë, por edhe një shans i humbur nëse Samiti i Parisit nuk i projekton parimet, pritjet dhe parametrat e qartë rreth dialogut", kështu ka thënë zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj gjatë një bashkëbisedimi me një grup vijuesish të Akademisë Diplomatike të Vjenës që po qëndrojnë për një vizitë studimore në Kosovë. Në këtë takim Hoxhaj ka theksuar se Kosova është e interesuar dhe e përgatitur për të arritur një marrëveshje. Sipas Hoxhaj, kjo

mund të bëhet nëpërmjet një bashkëbisedimi të ShBA-së dhe BE-së. "Por fare lehtë kjo mundësi e madhe e këtij viti mund të kthehet edhe në një zhgënjim të madh. Vetëm me një agjendë të mirëfilltë përmbajtësore dhe kohore e bën 2019-n mundësi për marrëveshje, në të kundërtën një vit të dështimit", është shprehur ai. Hoxhaj ka theksuar se Kosova falë edhe mbështetjes së miqve ka arritur ta forcojë vazhdimisht shtetndërtimin e brendshëm dhe ta zgjerojë sovranitetin e Kosovës duke u integruar në shoqërinë ndërkombëtare.



Flet për "Epokën e re", Hysni Gucati

Themelimi i tribunalit për krim



Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL-UÇK), Hysni Gucati, ka vlerësuar se institucionet shtetërore janë vonuar sa i përket themelimit të tribunalit për krimet serbe në Kosovë. Ai ka thënë se themelimi i këtij tribunal duhet të bëhet përmes ligjit dhe jo përmes rezolutës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gucati u ka bërë thirrje ambasadave të vendeve të Quintit që ta mbështesin Kosovën në këtë rrugëtim. Ai ka thënë se ka ardhur koha që Serbia të ndëshkohet për të gjitha krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë. Sipas Gucatit, nuk do të mund të ketë pajtim ndërmjet dy vendeve përderisa Serbia nuk kërkon falje për krimet dhe gjenocidin e kryer në Kosovë

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINE, 15 MAJ - Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL-UÇK), Hysni Gucati, u ka bërë thirrje deputetëve të Kuvendit të Kosovës që sa më shpejt të miratojnë ligjin për themelimin e tribunalit për krimet serbe në

Kosovë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se deputetët kanë gabuar kur kanë lejuar formimin e Gjykatës Speciale për shqiptarët, por jo edhe për serbët. "Ka gjasa që të themelohet tribunal për krimet serbe në Kosovë, prandaj e mbështesim edhe iniciativën e Veselit. Mirëpo kërkojmë që ky tribunal të bëhet përmes ligjit dhe jo me

rezoluta. Kuvendi i Kosovës ka miratuar shumë rezoluta, por gati të gjitha kanë dështuar. U bëjmë thirrje deputetëve të Kuvendit të Kosovës që sa më shpejt ta miratojnë ligjin për themelimin e tribunalit për krimet serbe në Kosovë", ka deklaruar Gucati.

Ai ka vlerësuar se institucionet shtetërore janë vonuar për themelimin e këtij tribunal

por, sipas Gucatit, më mirë vonë se kurrë. "Si OVL-UÇK nuk jemi vonuar sepse para tre vjetësh kemi kërkuar që të bëhet një tribunal special për të gjithë ata që kanë bërë krime luftime në Kosovë pa dallim etnie. Ata që kanë bërë krime duhet të dalin para drejtësisë pavarësisht se cilit komunitet i takojnë. Prandaj, ne nuk jemi vonuar dhe gjithmonë e kemi ngritur zërin, por janë vonuar Qeveria, Kuvendi dhe institucionet e Kosovës. Kuvendi i Kosovës ka formuar Gjykatë Speciale për shqiptarët, por jo edhe për serbët. Kjo lë të mbetet në ndërgjegjen e tyre. Dihet botërisht se krimet në Kosovë janë kryer nga policia dhe ushtria e Serbisë. Janë kryer mbi 450 masakra dhe askush nuk është gjykuar dhe dënuar", është shprehur Gucati. Ai u ka bërë thirrje ambasadave të vendeve të Quintit që ta mbështesin

Kosovën për themelimin e tribunalit për krimet serbe. Gucati ka theksuar se iniciativa për themelimin e këtij tribunal nuk do të dështojë pasi që, sipas tij, ka ardhur koha që Serbia të ndëshkohet për të gjitha krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë. "Nuk mund të ketë dështim kur janë faktet përpara. Ka shumë dëshmitarë të cilët mund të dëshmojnë për këto krime. Janë mbi 20 mijë gra të dhunuara. Njëra prej tyre është Vasfije Krasniqi-Goodman, e cila së fundi dëshmoi në Kongresin Amerikan për tmerrin e përjetuar. Në këtë rrugëtim besoj se do ta kemi përkrahjen e ShBA-së dhe të vendeve të Quintit. Por, nëse nuk përkrahët kjo iniciativë, tregon se bashkësia ndërkombëtare është duke luajtur me shqiptarët në Kosovë dhe po tenton ta barazojë krimin me viktimit", ka thënë Gucati, duke shtuar se nuk do të mund

et serbe të bëhet përmes ligjit

të ketë pajtim ndërmjet dy vendeve përderisa Serbia nuk kërkon falje për krimet dhe gjenocidin e kryer në Kosovë.

"Epoka e re": Z. Gucati, Organizata e Veteranëve e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare (OVL UÇK) nëpërmjet një letre publike ka kërkuar nga OKB-ja, ShBA-ja dhe BE-ja që ta themelojnë një tribunal për krimet serbe në Kosovë. Pse kjo kërkesë në këtë kohë e jo më herët?

Gucati: OVL-UÇK-ja ka kërkuar edhe më herët themelimin e një tribunali për krimin dhe gjenocidin në Kosovë. Përkatesisht para tre vjetësh shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së kanë kërkuar një tribunal të tillë dhe për këtë kanë qenë në dijeni të gjitha institucionet e Kosovës. Kështu që, themelimi i tribunalit për krimet serbe në Kosovë është i vonuar, por më mirë vonë se kurrë. Ne dëshirojmë dhe bëjmë thirrje që sa më shpejt të bëhet një tribunal special për krimet serbe që kanë ndodhur në Kosovë.

"Epoka e re": Pavarësisht prej thirrjes dhe mbështetjes suaj, sa ka mundësi që të bëhet realitet ky tribunal?

Gucati: Ka gjasa që të themelohet tribunali për krimet serbe në Kosovë, prandaj e mbështesim edhe iniciativën e Veselit. Mirëpo kërkojmë që ky tribunal të bëhet përmes ligjit dhe jo me rezoluta. Kuvendi i Kosovës ka miratuar shumë rezoluta, por gati të gjitha kanë dështuar. U bëjmë thirrje

deputetëve të Kuvendit të Kosovës që sa më shpejt të miratojnë ligjin për themelimin e tribunalit për krimet serbe në Kosovë.

"Epoka e re": Janë konsultuar institucionet shtetërore me OVL-UÇK-në për marrjen e iniciativës për themelimin e një tribunali të tillë?

Gucati: Para tre vjetëve kemi biseduar me kryeministrin, kryeparlamentarin, presidentin dhe të gjitha institucionet, kemi pasur takime dhe kemi përkrahur çdo iniciativë që është në të mirë të vendit dhe të qytetarëve të Kosovës. Edhe tani e përkrahim, sepse populli i Kosovës kërkon dënimin e kryerësve të masakrave, vrasjeve, dhunimeve dhe të gjitha krimeve të tjera që kanë ndodhur në Kosovë.

"Epoka e re": Iniciativa e Veselit dhe thirrja juaj për dënimin e krimeve serbe ka ardhur pas fillimit të punës së Gjykatës Speciale, përkatësisht pas intervistimit të disa ish-luftëtarëve të UÇK-së. Nuk mendoni se jeni vonuar në këtë drejtim?

Gucati: Kjo pyetje duhet t'i drejtohet Kuvendit dhe deputetëve. Si OVL-UÇK nuk jemi vonuar sepse para tre vjetësh kemi kërkuar që të bëhet një tribunal special për të gjithë ata që kanë bërë krime lufte në Kosovë pa dallim etnie. Ata që kanë bërë krime duhet të dalin para drejtësisë pavarësisht se cilit komunitet i takojnë. Gabimi më i madh ka qenë që deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë lejuar të formohet një gjykatë spe-

ciale e një etnie dhe nuk kanë kërkuar të bëhet gjykata për të gjithë ata që kanë bërë krime në Kosovë. Prandaj, ne nuk jemi vonuar dhe gjithmonë e kemi ngritur zërin, por janë vonuar Qeveria, Kuvendi dhe institucionet e Kosovës. Kuvendi i Kosovës ka formuar Gjykatë Speciale për shqiptarët, por jo edhe për serbët. Kjo lë të mbetet në ndërgjegjen e tyre. Dihet botërisht se krimet në Kosovë janë kryer nga policia dhe ushtria e Serbisë. Janë kryer mbi 450 masakra dhe askush nuk është gjykuar dhe dënuar.

"Epoka e re": Ju po insistoni që tribunali për krimet serbe duhet të bëhet përmes ligjit. Besoni se kjo legjislaturë ka gatishmëri për ta realizuar këtë?

Gucati: Këta e kanë ndryshuar Kushtetutën për Gjykatën Speciale, prandaj e kanë të gatshëm ligjin, vetëm se duhet të nxjerrin në rend të ditës për votim. Pra, besoj se këta deputetë kanë vullnet dhe gatishmëri për ta themeluar tribunalin. Sidoqoftë, letrën për themelimin e një tribunali për krimet serbe në Kosovë ua kemi dërguar edhe ambasada-ve të vendeve të Quintit dhe presim që ato ta përkrahin iniciativën për themelimin e këtij tribunali.

"Epoka e re": Në vazhdimësi keni deklaruar se drejtësia vendore, misionet e huaja në Kosovë, por edhe drejtësia ndërkombëtare ka dështuar për dënimin e krimeve serbe

në vendin tonë. Pse tani besoni se e njëjta bashkësi ndërkombëtare mund ta ndihmojë Kosovën në këtë rrugëtim?

Gucati: Sa iu përket krimeve serbe në Kosovë kanë dështuar të gjithë, UNMIK-u, EULEX-i, gjykatat tona dhe drejtësia ndërkombëtare. Tash gjërat kanë ndryshuar dhe presim që më në fund të dënohen krimet serbe në Kosovë. Iniciativa për themelimin e tribunalit nuk do të dështojë sepse ka fakte të bollshme për të dëshmuar krimin dhe gjenocidin e kryer nga Serbia në Kosovë. Nuk mund të ketë dështim kur janë faktet përpara. Ka shumë dëshmitarë të cilët mund të dëshmojnë për këto krime. Janë mbi 20 mijë gra të dhunuara. Një prej tyre është Vasfije Krasniqi-Goodman, e cila dëshmoi në Kongresin Amerikan tmerrin që ka përjetuar. Në këtë rrugëtim besoj se do ta kemi përkrahjen e ShBA-së dhe të vendeve të Quintit. Por, nëse nuk përkrahët kjo iniciativë, tregon se bashkësia ndërkombëtare është duke luajtur me shqiptarët në Kosovë dhe tenton ta barazojë krimin me viktimën.

"Epoka e re": Në rrethanat aktuale ndërkombëtare, mund të ndëshkohet Serbia për krimet e kryera dhe ta paguajë dëmshpërblimin e luftës siç po kërkon ju?

Gucati: Nuk do të ketë pajtim ndërmjet dy shteteve derisa Serbia nuk kërkon falje për krimin dhe gjenocidin e kryer në Kosovë si dhe nuk e kompenson dëmin e luftës.

Nënshkruhet marrëveshja për menaxhimin e spitaleve sipas praktikave ndërkombëtare

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 MAJ - Ministria e Shëndetësisë përmes Projektit të Shëndetësisë Kosovare, në kuadër të huamarrjes nga Banka Botërore, ka nënshkruar kontratë me kompaninë e njohur gjermane ICME për menaxhimin spitalor të spitaleve kosovare. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, kompania gjermane ICME do të angazhohet në tri shtylla kryesore që do të ndikojnë drejtpërdrejt në inxhinierimin e proceseve kyçe të menaxhimit sipas përvojave ndërkombëtare. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se QKUK-ja dhe spitalet e përgjithshme kanë

pasur mungesë të theksuar të menaxhimit të mirëfilltë spitalor ku si pasojë këtë situatë e kanë vuajtur pacientët, por edhe vetë profesionistët shëndetësorë. "Rrjedhimisht spitalet kanë ofruar më pak shërbime për qytetarët, ka pasur më pak logaridhënie, si dhe më pak efikasitet", ka thënë ministri Ismaili, duke shtuar se për shkak të mungesës së harmonizimit me praktika ndërkombëtare menaxhimi i këtyre komponentëve kryesore për funksionimin efikas të spitaleve nuk ka funksionuar. "Prandaj, kontrata e nënshkruar sot me kompaninë gjermane do të jetë kyçe për të na ndihmuar t'i shtojmë problemet dhe të krijojmë zgjidhje të qëndrueshme dhe të bazuara në

praktika ndërkombëtare", ka thënë ai.

Gjatë konferencës për media ministri Ismaili ka thënë se pritet edhe funksionalizimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Po ashtu, ai ka thënë se spitalet tona duhet të jenë në gjendje të kontraktujnë me Fondin.

Ambasadori gjerman në Kosovë, Christian Heldt, ka pohuar se kompania gjermane do të prodhojë rezultate për arritjen e një menaxhimi të institucioneve shëndetësore, ndërkohë që ka vlerësuar përkushtimin personal të ministrit Ismaili për përmirësimin e sektorit shëndetësor. Ndërkaq drejtori i Bankës Botërore për Kosovë, Marco Mantovanelli, u shpreh i



kënaqur për partneritetin me MSh-në dhe Fondin, duke shtuar se angazhimi i kompanisë gjermane do të jetë në funksion të ngritjes së kapaciteteve dhe menaxhimit sa më efikas të institucioneve shëndetësore. Drejtori i kompanisë gjermane ICME, Holger Micheel-Sprenger, u shpreh i lumtur që kompanisë

gjermane me repute i është besuar një marrëveshje përmes së cilës priten rezultate konkrete në menaxhimin spitalor në Kosovë. Kontrata e nënshkruar të mërkurën është në kuadër të Projektit të Shëndetësisë Kosovare me Bankën Botërore dhe do të zgjasë gjashtë muaj me mundësi vazhdimi.

Limaj: Nuk ka marrëveshje me Serbinë pa u zgjidhur çështja e të pagjeturve

PRISHTINË, 15 MAJ (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, njëherësh bashkëkryesues i Delegacionit Shtetëror për Bisedime me Serbinë, ka takuar të mërkurën komisionin qeveritar për persona të pagjetur, shoqatat e të pagjeturve dhe familjarët e të pagjeturve. Limaj ka thënë se Kosova i është qasur seriozisht kësaj çështje shumë të ndjeshme dhe të rëndësishme për vendin. Ai ka thënë se në platformën për bisedime me Serbinë një nga temat kryesore është çështja e të pagjeturve. Limaj ka siguruar se nuk ka marrëveshje me Serbinë pa pasur të qartë zgjidhjen e çështjes së të pagjeturve.

Ai e ka njoftuar komisionin qeveritar për persona të pagjetur, shoqatat e të pagjeturve dhe familjarët e të pagjeturve, se në takimin e delegacionit në Bruksel tema kryesore ka qenë çështja e ta pagjeturve. "U kemi bërë të qartë se Kosova nuk do të nënshkruajë asnjë marrëveshje me Serbinë nëse brenda saj nuk është e saktësuar çështja e të pagjeturve. Serbia duhet t'i hapë të gjithë arkivat shtetërore të ushtrisë, policisë dhe shërbimeve sekrete. Shteti serb i ka dosjet dhe informacionet e sakta për fatin e njerëzve tanë dhe ato duhet t'ia japë në dispozicion Kosovës dhe të marrë përgjegjësi", ka thënë Limaj.



Stacioni i trenit në Prishtinë do të bëhet muze i dëbimit të dhunshëm të shqiptarëve nga forcat serbe

EPOKA
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i shoqëruar nga ministri i Kulturës, Kujtim Gashi dhe nga menaxhmenti i "Infrakos"-it, ka vizituar të mërkurën lokacionin te Stacioni i Trenit në Prishtinë, i cili, sipas propozimit të kryeparlamentarit Veseli, do të shndërrohet në muze të dëbimit të shqiptarëve dhunshëm nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë. Kryeparlamentari Veseli ka thënë se ky muze do të jetë një kujtesë për të gjitha brezat dhe gjithë botën demokratike, për ta kujtuar formën dhe vendin e depërtimit të dhunshëm të dhjetëra mijëra qytetarëve të Prishtinës nga pronat e tyre. "Shqiptarët kanë pasur dëbime në mënyrë historike. Vetëm ta mendojmë dëbimin nga Sanxhaku i Nishit dhe vise të tjera. Unë sot jam këtu për të dëshmuar edhe një herë përkushtimin e institucioneve për të marrë vendime të drejta. Ato nuk janë të drejtuara kundër askujt, por për t'i dhënë perspektivë rajonit dhe që e vërteta



të dalë në shesh. Kjo e vërtetë është se shqiptarët janë dëbuar, vrarë dhe masakruar në mënyrë të organizuar nga shteti serb", ka thënë Veseli. Ai ka shtuar se Serbia ka kryer gjenocid mbi shqiptarët dhe se ky realitet nuk

do të harrohet, ndërsa kriminelët do të përgjigjen për krimet e tyre. "Nesër Kuvendi do të propozojë që ky stacion i trenit të shndërrohet në muze të dëbimit të shqiptarëve. Le të vijnë gjeneratat e reja, le të vijnë edhe

ndërkombëtarët dhe le ta shohin atë copë të realitetit tonë të para 20 vjetëve", ka theksuar Veseli. Ali Kadrolli, i cili personalisht me familje e kishte përjetuar dëbimin e dhunshëm me tren, ka rrëfyer se si i ka hipur, nëpërmjet

ditave të trenit, prindërit e tij të cilët më pas janë depërtuar për në Maqedoni. Ai ka thënë se kjo iniciativë e kryeparlamentarit Kadri Veseli është shumë e qëlluar dhe do të mbetet gjithmonë në kujtesën e qytetarëve.

Ministria e Mjedisit do të investojë rreth 3 milionë euro në Skenderaj, Istog, Viti dhe Deçan

PRISHTINË, 15 MAJ (ER) - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, së bashku me kryetarët e komunave: Skenderaj, Istog, Viti dhe Deçan, kanë nënshkruar disa memorandume bashkëpunimi për realizimin e projekteve në fushën e mjedisit. "Jam i përkushtuar që si ministër i një dikasteri të rëndësishëm për

komunat dhe qytetarët, t'u dal në ndihmë gjithë kryetarëve të komunave për t'i shtyrë përpara projektet që kanë të bëjnë me mjedisin. Vetëm gjatë vitit 2019 MMPH-ja ka planifikuar 84 projekte që përfshijnë edhe komunat e Kosovës, në mesin e këtyre edhe komunat Skenderaj, Istog, Viti e Deçan", ka deklaruar ministri Matoshi. Ai ka thënë se këto

projekte do të financohen nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në vlerë rreth 3 milionë euro. I pari i MMPH-së ka kërkuar nga kryetarët e komunave angazhim më të madh në fushën e mjedisit, duke përfshirë edhe zbatimin e Udhëzimit Administrativ për ndëshkime me gjoba mandatore.



Kur është i mundur liberalizimi i vizave për Kosovën?

Derisa kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, shpreh optimizëm për mundësinë e liberalizimit të vizave për Kosovën, në Bruksel askush nuk flet për datën e heqjes së vizave për qytetarët e Kosovës. Por si realizohet ky proces në BE?

PRISHTINË, 15 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka dhënë një parashikim se regjimi i vizave për kosovarët për udhëtim në vendet Shengen mund të hiqet në muajin shtator 2019. Duket se kjo deklaratë ka ardhur pas premtimeve që ai ka marrë në Berlin gjatë samitit të fundit. "DW" ka arritur të konfirmojë se edhe ministri i Punëve të Brendshme të Gjermanisë, Horst Seehofer, që është personi përgjegjës për këtë punë, ka dhënë mbështetjen e tij për heqje të vizave për kosovarët. Ky ishte ndryshimi që u arrit pas samitit të Berlinit.

Në Bruksel askush nuk guxon të flasë për datë të heqjes së vizave për kosovarët. Madje pak ka diplomatë që dëshirojnë të flasin për këtë punë në kohën kur Bashkimi Evropian është duke zgjedhur parlamentin e ri, i cili sfidaohet nga populizmi i djathtë.

Rumania duhej ta fuste çështjen e liberalizimit të vizave me Kosovën - pak shanse që kjo të ndodhë

Sipas rregulloreve të marrëveshjes Shengen, që të kalojë vendimi për liberalizimin e vizave duhet të ndodhin dy gjëra: Vendi që

mban presidencën e BE-së duhet ta fusë çështjen në agjendë dhe vota duhet të përkrahët nga " shumica e kualifikuar". Në gjashtëmujorin e parë të 2019-s Rumania mban presidencën e Bashkimit Evropian. Ajo duhet ta fusë këtë çështje në agjendë. Mundësia që të ndodhë kjo nuk është shumë e madhe, pasi ky shtet nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës dhe nuk duket se Bukureshti do të mund ta përkrahë apo të marrë një iniciativë për afrimin e Kosovës në BE.

Problemi tjetër me Rumaninë është se ajo ndodhet nën presionin e vendeve të tjera të BE-së për shkak të korrupsionit të lartë në këtë vend. Komisioni Evropian të martën (13.05) kërcënoi me vendosjen e sanksioneve nëse Rumania aprovon një ligj që mbron të korrumpuarit nga ligji. Kjo gjë e vështirëson mundësinë që vendet perëndimore apo miqtë e Kosovës të kenë mundësi që të kërkojnë nga Rumania që të fusë në agjendë një gjë që është me interes të vogël për BE-në, komentojnë diplomatët. Edhe pse Rumania nuk preket nga vendimi i liberalizimit, pasi nuk është pjesë e Shengenit, ata përcaktojnë agjendën.



Roli kyç i Francës

Çështja e dytë që mbetet pikëpyetje është kalimi i votës me " shumicë të kualifikuar". Për të arritur këtë numër duhet që për liberalizimin e vizave të votojnë më shumë se 55 për qind e shteteve anëtare të Shengenit, që nuk përbën problem, por këto duhet të jenë vendet që përfaqësojnë 65 për qind të popullsisë së përgjithshme në vendet që votojnë. Duke marrë këtë parasysh, nëse të gjitha vendet që nuk e kanë pranuar Kosovën dhe janë në Shengen votojnë kundër dhe këtyre iu bashkëngjitet edhe

Franca dhe Holanda që momentalisht janë kundër me deklaratë, atëherë vota nuk do të kalojë. Nëse njëra nga vendet që nuk e ka njohur Kosovën, por janë pozitivisht të disponuara ndaj vendit, si Greqia dhe Sllovakia, do votonte për, atëherë vota do të kalojë edhe pa Francën dhe Holandën. Mirëpo është vështirë të besohet se ndonjë votë do të kalojë pa bekimin e një vendi siç është Franca. Kyçe në këtë votë është Franca, pohojnë diplomatët, përkatësisht presidenti Macron. Diplomatët francezë, kur flasin privatisht, janë në përkrahje të liberalizimit të vizave për Kosovën, por pjesa politike e

presidentit francez ka bllokuar secilën lëvizje drejt zgjerimit të BE-së, duke përfshirë edhe liberalizimin e vizave. Kjo pjesë e administratës franceze madje ka sugjeruar, se heqja e vizave për Shqipërinë dhe Gjeorgjinë ka qenë gabim.

Analistë thonë se pa votën e Francës as vendet e tjera nuk do të kërkojnë që votimi të ecë përpara. Udhëheqësit kosovarë do të shkojnë në Paris për vazhdimin e Samitit të Berlinit. Në qershor ata do të takohen personalisht me presidentin Macron dhe mund ta bindin atë, por edhe mund të dështojnë për arritjen e këtij hapi diplomatik për Kosovën.

KQZ-ja akreditoi 464 vëzhgues për zgjedhjet në komunat e veriut

PRISHTINË, 15 MAJ (ER) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës të kryesuar nga kryetarja Valdete Daka. Në këtë mbledhje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve akreditoi vëzhguesit të cilët do t'i vëzhgojnë zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, të cilat do të mbahen më 19 maj.

Numri i vëzhguesve të akredituar është 464.

Këta vëzhgues përfaqësojnë dy parti politike, dy misione ndërkombehtarë, një Komision Evropian, dy misione diplomatike, dymbëdhjetë ambasada, një OJQ ndërkombehtarë, katër OJQ vendore dhe pesëmbëdhjetë media.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

(KQZ) ka certifikuar listën përfundimtare të votuesve me ç'rast është bërë me dije se rreth 58 mijë qytetarë kanë të drejtë vote për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë të katër komunave në veri të vendit. Të drejtën e votës 57 983 qytetarët e katër komunave në veri mund ta shfrytëzojnë në 44 qendra të votimit, përkatësisht në 87 vendvotime.

Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në komunat Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan do të mbahen më 19 maj. Katër kryetarët e këtyre komunave më 27 nëntor të vitit 2018 kanë dhënë dorëheqje, duke kundërshtuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për vendosjen e taksës 100 për qind ndaj prodhimeve të importuara nga Serbia.



Multikulturalizimi nga parlamenti maqedonas, një leksion për Aleksander Vuçiqin?



Salihe SALIHU -
PhD kandidat

Këto ditë u mbajtën zgjedhjet presidenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në garën për president, pas përfundimit të numërimit të votave, fitues doli Stevo Pendarovski. Ky emër tingëllon i njohur edhe për trevën kosovare pasi paraprakisht u problematizua kandidatura e kandidatëve për

shkak të përkatësisë etnike politike. Disa parti shqiptare mendonin se kandidatuarat e Blerim Rekës duhet përkrahur, ndërsa partia më e madhe e shqiptarëve, Bashkimi Demokratik për Integritim, përkrahi kandidaturën për president konsensual në mes të partisë së Ali Ahmetit dhe Zoran Zaevit.

Këto mospajtime për kandidatë u shuan në prag të ditës për të votuar dhe bëhej thirrje për të marrë pjesë masivisht duke konsideruar se vota e qytetarëve është në dobi të shtetit dhe gjithë shtetasve.

Fitorja e presidentit Stevo Pendarovski rriti ndjenjën e shpresës se tani e tutje Maqedonia do të jetë bartëse e

vlerave multikulturaliste. Pikërisht këto vlera multikulturaliste u shfaqën në ditën kur presidenti i sapozgjedhur bënte betimin në parlamentin maqedonas që udhëhiqej në gjuhën shqipe nga kryeparlamentari Taulat Xhaferi.

Në këtë ceremoni inauguruese u ftuan edhe presidentët e rajonit, në mesin e tyre, përveç presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ishte i pranishëm edhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

Ceremonia zhvillohej në gjuhën shqipe dhe ky ishte një flakësh mjaft i nxehtë për Vuçiqin, të cilit iu xhindos fytyra gjatë mbajtjeve të kufjeve në vesh për ta kuptuar përkthimin nga shqipja në gjuhën

që ai e kuptonte.

Sigurisht që kjo ngjarje do të jetë pak me pasoja traumatike për Aleksandër Vuçiqin i cili do të bie në depresion nga realiteti me të cilin u ballafaqua ai në parlamentin maqedonas. Por, pas depresionit, nëse Aleksandri dëshiron të kurohet, duhet kuptuar se e ardhmja paqësore është e dizajnuar nga një qasje e re sipas modelit të multikulturalizimit.

Gjithashtu, nëse Aleksander Vuçiqi do të përcaktohet me qasjen e re drejt së ardhmes paqësore e multikulturore do t'i kontribuonte vërtet në radhë të parë Serbisë për ta drejtuar shtetin e vet drejt familjes evropiane e jo ta shantazojë popullin e vet dhe gjithë

Evropën përmes Ruisë, e cila me territor gjysmaziatike e gjysmevropiane ka ngelur sikur krimbi i dheut në mes dy kontinenteve.

Pos kësaj, nëse Aleksander Vuçiq ndryshon kursin e vet dhe instalon frymën paqësore, duhet t'i respektojë shtetet fqinje e, para së gjithash, duhet ta njehë edhe Republikën e Kosovës që është shtet fqinj i shtetit të tij.

Kështu që, parlamenti maqedonas me qasjen e vet paqësore e multikulturore natyrshëm e ka ngacmuar qasjen ultra nacionaliste dhe hegjemoniste të Aleksander Vuçiqit duke ia dhënë këtij një leksion se çfarë qasje duhet të ndjekë rajoni ballkanik.

Nënshkruhet protokollin për ndërtimin e integritetit në sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes në Kosovë

PRISHTINË, 15 MAJ (ER) - Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës dhe Qendra e Integritetit të Norvegjisë nënshkruan protokoll të qëllimit për Ndërtimin e Integritetit në Sektorin e Sigurisë dhe të Mbrojtjes në Kosovë. Ky projekt është pjesë më e gjerë në Ballkanin Perëndimor, i financuar nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme, e ekzekutuar në periudhën 1 prill 2018, deri më 31 dhjetor 2020, ku Ministria e

Mbrojtjes e Norvegjisë e ka emëruar CIDS si agjentin ekzekutiv për këtë projekt. Nënshkrimin e protokollit e bënë Per Age Christensen në emër të CIDS e në emër të MPB-së sekretari i përgjithshëm Lulzim Ejupi. Me këtë rast, sekretari i përgjithshëm i MPB-së, Lulzim Ejupi, ka falënderuar Mbretërinë e Norvegjisë për mbështetjen dhe ndihmën e ofruar në kuadër të projektit për ndërtimin e integritetit në sek-

torin e sigurisë dhe të mbrojtjes, ku përfitues është edhe Ministria e Mbrojtjes. "Integriteti dhe llogaridhënia janë ndër shtyllat kryesore të qeverisjes së mirë dhe funksionimit të administratës shtetërore, ku përmes tyre sigurohet dhe promovohet interesi publik kundrejt interesit apo përfitimeve private. Sektori i sigurisë, veçanërisht agjencitë e zbatimit të ligjit, kanë rol kryesor në sistemin e integritetit", ka thënë Ejupi.



Kompensimi i orëve të humbura, SBASHK-u do t'i drejtohet Gjykatës së Apelit

SBASHK-u ka vlerësuar se aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë nuk është i bazuar në argumente, por në emocione të çastit. "SBASHK-u është me arsye i pakënaqur me Aktgjykimin A. nr. 552/19 lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, prandaj do t'i drejtohet me ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës

PRISHTINË, 15 MAJ (ER) - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës e Republikës së Kosovës (SBASHK) ka bërë me dije se nuk është e kënaqur me vendimin e Gjykatës Themelore për kompensimin e orëve të humbura dhe për këtë aktgjykim do t'i drejtohet Gjykatës së Apelit. Nëpërmjet një komunikate për medie SBASHK-u ka vlerësuar se aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë nuk është i bazuar në argumente, por në emocione të çastit. "SBASHK-u është me arsye i pakënaqur me Aktgjykimin A. nr. 552/19 lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, prandaj do t'i drejtohet me ankesë

Gjykatës së Apelit të Kosovës, me kërkesën që të anulohet ky aktgjykim sepse konsiderojmë se, veç të tjerash, Gjykata Themelore në Prishtinë, për ta sjellë aktgjykimin e saj në dobi të vendimit të pabazuar në ligj të MASHIT-it lidhur me kompensimin e orëve të humbura në grevën e janarit, nuk është bazuar në argumente, por në emocione të çastit, madje fitohet përshtypja se edhe ka qenë e ndikuar politikisht nga deklaratat e disa prej institucioneve, debateve të një pjese të deputetëve në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit dhe nga individë të ashtuquajtur Këshillë të Prindërve", është thënë në komunikatën e SBASHK-ut.



Gjermania mbështet Kosovën me dy milionë euro për Qeverisjen e Mirë Financiare

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 15 MAJ - Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë kanë nënshkruar të mërkurën marrëveshjen implementuese për fazën e IV të projektit të Qeverisjes së Mirë Financiare në vlerë prej dy milionë eurosh. Marrëveshja u nënshkrua nga ministri i Financave, Bedri Hamza, ambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, dhe drejtori i GIZ-it për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut, David Oberhuber, në praninë e sekretarit gjeneral të Kuvendit të Kosovës, Ismet Krasniqi dhe udhëheqëses së projektit për Qeverisje të Mirë Financiare, Kadri Jogiste.

Me këtë rast, ministri Bedri Hamza ka bërë me dije se kjo marrëveshje parasheh mbështetje të drejtpërdrejtë në formë të asistencës teknike për Ministrinë e Financave dhe

agjencitë e saj, si dhe për Kuvendin e Kosovës, përkatësisht Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike dhe njësitë mbështetëse të tyre.

Faza IV e këtij projekti pritet të implementohet përgjatë periudhës 2019-2020. "Në fazën IV të këtij projekti e mirëpresim ndryshimin e qasjes së projektit që të jetë më gjithëpërfshirëse dhe të punojë së bashku me të gjitha departamentet e përfshira në procese të caktuara të menaxhimit të financave publike", ka thënë ministri Hamza. Ai theksuar se Ministria e Financave mirëpret edhe zgjerimin e mëtutjeshëm të fushëveprimit të Portalit të Transparencës të paraparë me këtë fazë si dhe zbatimin e udhëzimeve administrative për investime kapitale, transferime dhe rialokime.

Ministri Hamza ka bërë me dije se projekti për Qeverisje të Mirë Financiare ka filluar të zbatohet në vitin 2009 dhe deri më tani me sukses janë kryer tri faza të



këtij projekti, me fokus në qeverisjen financiare në Kosovë, në veçanti llogaridhënie, transparencë dhe efektivitet të planifikimit dhe shpenzimeve.

Ndërsa ambasadori gjerman Christian Heldt ka theksuar se një nga sukseset për të cilat e përgëzojnë Qeverinë e Kosovës

është lansimi i Portalit të Transparencës Buxhetore. "Që nga fillimi i bashkëpunimit në vitin 2009, qëllimi i këtij projekti ka qenë forcimi i qeverisjes së mirë financiare të Kosovës, me theks të veçantë në llogaridhënien, transparencën dhe efektivitetin në

procesin e punës. Duke u bazuar në bashkëpunimin tonë të suksesshëm me Ministrinë e Financave, Kuvendin e Kosovës dhe Administratën Tatimore, Qeveria e Gjermanisë dhe GIZ-i presin me padurim fazën e re të projektit", ka thënë Heldt.

Mbi 20 milionë euro vetëm për këshilltarë të projektit 'Kosova e Re'

PRISHTINË, 15 MAJ (ER) - Balkan Green Foundation (BGF), Instituti GAP, Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), në kuadër të kampanjës "mosthujsekamdite", kanë njoftuar opinionin e gjerë për shumën e mjeteve të shpenzuara deri më tani vetëm për këshilltarë të projektit "Kosova e Re". "Këtë muaj Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZhE) ka shpallur tender me vlerë referenciale prej katër milionë eurosh për blerjen e shërbimeve



të konsulencës për projektin e 'Kosova e Re'. Me këtë tender, shpenzimet për këshilltarë të projektit 'Kosova e Re' do të arrijnë mbi 20 milionë euro", është bërë me dije në njoftimin për media të këtyre organizatave.

Sipas këtij njoftimi, në vitin 2006 Banka Botërore për herë të parë

ka angazhuar këshilltarë të transaksionit, ku deri më 2011 u shpenzuan 16,4 milionë dollarë (12 milionë euro, sipas mesatares së këmbimit të valutës për periudhën 2006-2011), prej të cilave 5.5 milionë dollarë (4 milionë euro) janë mbuluar nga buxheti i Kosovës. "Në vitin 2011, Qeveria e Kosovës mori përsipër të angazhojë kompani konsulente për projektin 'Kosova e Re', ku u shpenzuan edhe 3.9 milionë euro. Nga viti 2012 deri më 2015 përmes disa kontratave për shërbime,

Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka angazhuar tre menaxherë të ndryshëm të projektit së bashku me staf mbështetës për një vlerë të përafërt prej 200 mijë eurosh. Për më tepër, individë të cilët janë angazhuar nga Qeveria e Kosovës për ta menaxhuar projektin 'Kosova e Re', tani shërbejnë si punonjës të investitorit privat (Contour Global) të përzgjedhur për të investuar në këtë projekt", thuhet në këtë njoftim.

Balkan Green Foundation (BGF), Instituti GAP, Grupi për

Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ditë më parë bënë thirrje që të anulohet tenderi prej katër milionë eurosh për shërbimet e konsulencës për projektin 'Kosova e Re'.

Gjithashtu, organizatat e lartshënuara të shoqërisë civile kërkojnë tërheqjen e menjëherëshme të Kosovës nga kontrata për ndërtimin e këtij termocentrali ngaqë kjo kontratë vendos një barrë të padurueshme mbi buxhetin e shtetit.

Përpunuesit e drurit vlerësojnë vendimin e ministrit Shala për ndalimin e eksportit të masës drusore

PRISHTINË, 15 MAJ (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, bashkë me zëvendëskryeministrin Fatmir Limaj, kanë vizituar të mërkurën kompaninë e prodhimit të mobileve "Elnor" për ta parë nga afër efektin e vendimit të fundit që ndalon eksportin e masës drusore. Shala ka shprehur gatishmërinë për vazhdimin e mbështetjes për prodhuesit vendorë dhe ka bërë

me dije se vendimi i fundit për ndalimin e eksportit prodhuesit e mobileve i bënë më konkurrues.

Shala i ka siguruar prodhuesit vendorë për përkushtimin e vazhdueshëm me qëllim që ta kenë më të lehtë eksportin. Kjo, sipas tij, do ta ndihmojë edhe zhvillimin ekonomik të vendit dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Ndërsa zëvendëskryeministri

Fatmir Limaj ka thënë se përmes vizitës në këtë kompani donin t'i përcillnin mesazhet për të gjitha kompanitë që merren me këtë lëmë. "Para disa dite ministri Shala ka propozuar në qeveri një vendim të rëndësishëm dhe donim të shihnim efektin që ka pasur ai vendim. Nga ajo që ne dëgjuam, ka qenë një vendim i jashtëzakonshëm për këtë kompanitë", ka thënë Limaj.



30 shtëpi të reja do të ndërtohen në Prizren

PRIZREN, 15 MAJ (ER) - Me qëllim të krijimit të kushteve për banim për familjet në nevojë, të mërkurën kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, së

bashku me themeluesin e Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", Halil Kastrati, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për ndërtimin e

30 shtëpive. "Përveç kësaj marrëveshjeje Komuna e Prizrenit këtë vit me të hyrat komunale do t'i ndërtojë edhe 30 shtëpi të tjera, ndërkaq do të rinovojë

edhe 30 shtëpi dhe 30 kulme, duke bërë kështu zgjidhjen e problemit të banimit për së paku 120 familje nevojtare", ka thënë Haskuka.



Përkujtohen dëshmorët Malush Ahmeti dhe Faik Goxhuli

SKENDERAJ, 15 MAJ (ER) - Nën kryetari i Komunës së Skenderajt, Nuredin Lushtaku, drejtorët komunalë, familjarët, bashkëluftëtarët dhe përfaqësuesit e shoqatave të dala nga

lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë bërë homazhe te varret e dëshmorëve të kombit Malush Ahmeti dhe Faik Goxhuli në kujtim të sakrificës sublime të tyre për lirinë e

Kosovës. Për nder të 20-vjetorit të rënies së tyre është lartësuar vepra e heronjve të ushtrisë së lavdishme çlirimtare që sakrifkuan jetën për lirinë dhe pavarësinë e vendit.

Komuna e Drenasit shpërblehet me dy çmime të rëndësishme

DRENAS, 15 MAJ (ER) - Komuna e Drenasit është shpërbleyer me dy çmime: "Çmimin për arritje në fushën e përfaqësimit të barabartë gjinor në vitin 2018", si dhe "Çmimin për performancën më të mirë komunale për vitin 2018". Ndarja e çmimeve u bë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ku ministrja Adriana Hoxhiq ka

ndarë çmimet në një ceremoni solemne. Çmimet i ka pranuar kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci. Kryetari Lladrovi ka thënë se këto shpërblime janë një tregues i angazhimit të vazhdueshëm të Komunës së Drenasit e cila vazhdon të mbetet promotore dhe shembull i zbatimit të ligjit dhe vlerave demokratike.



Gërmizaj zëvendëson Susurin në pozitën e drejtorit të Arsimit në Prizren

PRIZREN, 15 MAJ (ER) - Skender Susuri nuk do të jetë më drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) në Komunën e Prizrenit. Kjo është bërë me dije në një konferencë të për-bashkët për medie të kryetarit të Prizrenit, Mytaher Haskuka, dhe Skender Susurit, ku është thënë se një gjë e tillë ishte kërkuar nga drejtuesit e partisë së tij, Nisma Socialdemokrate.

Drejtori i deritanishëm i Arsimit në Prizren ka thënë se partia e tij nuk është duke e përkrahur dhe se ka pasur presion lidhur me konkurset për punë në sektorin të cilin e ka udhëhequr. Në vend të Susurit është emëruar Gani Gërmizaj i cili, po ashtu, është pjesë e Nismës Socialdemokrate. "Të dashur miq, të nderuar qytetarë, dua të ndaj një lajm me



ju. Nga sot do të jem i ngarkuar me një detyrë të re. Pra, nga sot jam emëruar drejtor i DKA-së në Komunën e Prizrenit. Falënderoj Nismën Socialdemokrate, pastaj Degën e Nismës në Prizren dhe kryetarin Zafir Berisha për besimin e dhënë. Garantoj se puna dhe detyra ime e re do të jetë në përputhje të plotë me ligjin, rregulloret dhe

udhëzimet administrative që janë në fuqi. Po ashtu, zotohem se të gjitha angazhimet e mia do të jenë të bashkërenduara dhe në harmoni të plotë me politikën që janë të hartuara nga koalicioni qeverisës komunal, respektivisht nga kryetari i komunës, Mytaher Haskuka", ka shkruar Gërmizaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Komuna e Malishevës merr përsipër mbulimin e shërbimit të varrimit

MALISHEVË, 15 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, dhe kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Malishevë, Mulla Xhevat Kryezat, kanë nënshkruar marrëveshje për mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e varrimit të personave të vdekur të cilët varrosen në territorin e kësaj komune. Kostoja e përgjithshme e mar-

rëveshjes për një shërbim mortor është 230 euro, të cilat do të mbulohen me mjete buxhetore të Komunës së Malishevës. Mbulimi i shpenzimit për shërbimet e varrimit sipas kësaj marrëveshjeje në asnjë mënyrë nuk ndërlidhet me pagesën e anëtarësisë ndaj Bashkësisë Islame, çështje e cila edhe më tutje mbetet në raportet e deritanishme të qytetarëve me

Bashkësinë Islame. Kuvendi i Komunës së Malishevës gëzon të drejtën e shkëputjes së njëanshme të marrëveshjes në rast se Këshilli i Bashkësisë Islame në Malishevë nuk përmbush obligimet e veta sipas nenit 2 dhe 5 të kësaj marrëveshjeje. Marrëveshja fillon të zbatohet prej datës 1 janar 2019 dhe përfundon më 31 dhjetor 2020.



SHKATËRRUESIT E ATDHEUT DHE DHUNUESIT E MËMËDHEUT!



**Shkruan: Behxhet
Sh. SHALA - BAJGORA**

Shqipëria si mohuese e bashkimit kombëtar: Në rrethana normale Shqipëria do të duhej të ishte apo ta luante rolin e Panteonit apo strumbullarit - kërthizës ku lidhet pazgjidhshëm e kaluara, e tashmja dhe ardhmëria e të gjithë shqiptarëve kudo që jetojnë. Të gjitha shtetet, vendet e rajonit këtë çështje e kanë rregulluar në mënyrë që i ka pajisur me pasaporta të gjithë ata që e kanë vendin e origjinës shtetin që i ka lëshuar dokumentin e udhëtimit dhe të tjera pavarësisht se ku kanë jetuar apo ku kanë lindur. Shqipëria këtë nuk e ka bërë, përjashtuar rastet kur kanë pasur interes biznesi, kanë qenë bashkëmendimtarë apo bashkëpjesëmarrës të një komuniteti kriminal të njëjtë, e kanë shitur shtetësinë për para, e kanë përdorur apo keqpërdorur për qëllime dhe nevoja politike duke pajisur me pasaporta (madje edhe diplomatike) ata që tërë jetën kanë punuar kundër interesave kombëtare, i kanë shërbyer qençe Jugosllavisë dhe Serbisë, kurse në pak raste kanë bërë vlerësime të drejta dhe parimore se kush duhet ta fitojë shtetësinë shqiptare. Ju kujtohet kur "gjyshi digjital" për të mbajtur apo për të marrë pushtetin pati propozuar që gjithë shqiptarët, kudo që jetojnë të pajisën me pasaporta të Shqipërisë. Bashkësia ndërkombëtare e njohur për standarde të dyfishta dhe pafytyrësi menjëherë e kërcënoi Shqipërinë e cila u zbyth me një shpejtësi të zërit, por se nuk pati kërkesa të njëjta edhe për shtetet e tjera. Shqipëria që nga përmbysja e sistemit totalitarist kur u bë një kapërcim nga një diktaturë absolute në një demokraci komuniste të tipit të konverimit të UNMIK-ut në EULEX, asnjëherë nuk ka qenë e rrezikuar nga Greqia, Serbia, Mali i Zi apo Maqedonia por, gjithnjë është rrezikuar nga vet shqiptarët, mafia politike dhe baronët e drogës sikur

edhe trafikantët me qenie njerëzore. Vet shqiptarët ia kanë futur flakën Shqipërisë duke e lënë pa kufij disa herë, dhe nga ky aspekt nuk mund të gjeni popull në Evropë apo botë që ka punuar kundër vendit që të tjerët e mbrojnë me të gjitha mjetet.

Tre persona kanë përgjegjësi për gjendjen në të cilën është sot Shqipëria, "Mbreti" Zog, diktatori Hoxha dhe "gjyshi digjital", Sali Berisha për faktin se kanë sunduar mbi shqiptarët kohën më të madhe, që nga shpallja e pavarësisë më 28 nëntor 1912 e deri më sot. Që të tre kanë pasur detyrim kushtetues t'i bashkojnë trojet shqiptare e që nuk e kanë bërë. "Mbreti" Zog, jo që nuk i ka bashkuar trojet shqiptare, por edhe ka falur troje shqiptare për të mbetur në pushtet. Enver Hoxha, jo që nuk i ka bashkuar trojet shqiptare, por as që ka lëvizur gishtin e vogël në vitin 1945, kur Kosova u detyrua t'i bashkohej Jugosllavisë. Radhët partizane të Shqipërisë, në vend që të radhiten në anën e nacionalistëve shqiptarë që nuk donin të qëndronin nën pushtimin sllav, ata në mënyrë aktive morën pjesë në shuarjen me gjak të kryengritjes së Drenicës që udhëhiqej nga Shaban Polluzha dhe Mehmet Gradica, sikur që nuk e ndër-morën asnjë veprim për ta parandaluar masakrën e Tivarit ku u vranë me mijëra e mijëra shqiptarë. Sali Berisha, në kohën kur bashkësia ndërkombëtare i vuri embargo për furnizim me karburante Jugosllavisë kriminale për ta penguar lëvizjen e ushtrisë dhe policisë jugosllave dhe serbe, liqenin e Shkodrës e shndërroi në treg të lirë për Jugosllavinë dhe Serbinë, në emër të një patriotizmi idiotesk.

Krejt këta alienë politikë ndikuan dhe po ndikojnë ta kemi një gjendje në Shqipëri ashtu si e kemi sot. Nëse i përcillni protestat e opozitës skajshmërisht të korruptuar, njerëzisht, kombëtarisht, moralisht dhe me udhëheqës të kriminalizuar deri në palcë, nuk ka pse të befasoheni për urrejtjen që e shprehin gjatë protestave, si ndaj institucioneve legjitime, ashtu edhe ndaj objekteve ku janë vendosur këto institucione. Po ta kishin këtë vendosmëri, vullnet dhe kriminalizim veprues kundër dukurive negative që kanë përfshirë gjithandej shtetin

dhe politikën shqiptare, po ta kishin këtë gatishmëri për të mbrojtur Kosovën nga Serbia kriminale dhe fashiste që udhëhiqet nga kriminelët Vuçiq, Daçiq, Sheshel, Odallovic, Vulin dhe të tjerët, opozita shqiptare do ta shkruante historinë, jo vetëm të Shqipërisë, por edhe të tërë shqiptarisë.

Do të integrohej në Evropë moti si pjesë e shëndoshë e demokracisë e jo si pjesa më e shëmtuar e vlerave njerëzore, si krimi i organizuar që po ndodh sot. Liderët e opozitës me një të kaluar dhe të tashme puro kriminale, pasuri dhjetëra e qindra milionë euro të bëra nga krimi, me një patriotizëm primitiv folklorik, udhëheqin protestat duke bërë garë se kush po bën më shumë dëm ndaj institucioneve, policisë dhe shtetit shqiptar. Po kush është ai i marrë që do të investonte për të bërë biznes në Shqipëri në rrethanat aktuale kur nuk keni siguri se hoteli ku jeni vendosur nuk do të shndërrohet në gërmadhë nga vandalët e opozitës, të manipuluar dhe udhëhequr nga liderë të korruptuar apo neronë modern, që ndonëse artin nuk e kanë frymëzim për shkatërrimin e Shqipërisë përveç rrugaçerisë dhe banditizmit kriminal, nga motive të ulëta pikërisht këtë e bëjnë?! Cili është ai i marrë që do të bëjë turizëm në Shqipëri këtë vit e të mos ketë frikë se mund të bien në pritë të Bashës, "gjyshit digjital" apo Moninkës e të plaçkiten detin në lekun e fundit?! Ku e ka burimin ky sadizëm ndaj kundërshtarëve politikë e që trajtohen më keq se të ishin armiq apo robër luftime që e demonstroi opozita ndaj opozitës sikur edhe ky mazohizëm që e ushtron opozita ndaj anëtarëve të saj, përveç të krimbi i vetëshkatërrimit, i shndërruar tashmë në elefant të tërbuar që rrëzon çdo gjë që e gjen gjatë rrugëtimit vdekjeprurës dhe apokaliptik. Po të ishte vetëm përgjegjësi e opozitës, do të ishte vetëm gjysma e së keqes për faktin se e kemi një pozitë që ka legjitimitet dhe legalitet të mandatuar me votën e qytetarit, dhe e cila gjithashtu është shumë e kriminalizuar. E keqja e Shqipërisë qëndron në faktin se piramida sunduese përbëhet nga themeli i kriminit të organizuar të të gjitha profileve, e cila përfundon me një maje politike e përbërë nga politikanët të korruptuar që e

mirëmbajnë bazën kriminale dhe të cilët politikisht dhe fizikisht jetojnë dhe mbijetojnë falë kësaj baze të kriminit të organizuar. Në krye të pozitës është një kryeministër i cili me retorikën dominuese ndaj kundërshtarëve politikë, medie dhe shoqërisë civile është shndërruar në një monstrum dhe kontrabandues të demokracisë. Besimin e shqiptarëve të Kosovës dhe viseve tjera jashtë Shqipërisë, Edi Rama e ka përdhunuar skajshmërisht. Sloganet patriotike të brohoritura në Beograd, në fillim të rrugëtimit të tij drejt vendosjes së një diktature demokratike, të ripërsëritura çdoherë kur ka pasur nevojë për infuzion patriotik e që janë të ndërlydhura me probleme të mungesës së testosteronit e që për pasojë ka klimaksin politik dhe veprues, Edi Rama i ka përdorur si perde tymi që përdorët në dasmat provinciale ku këndojnë vlerat e dëshmuara kombëtare dhe artistike, Linda Morina dhe Daja i Kombinatit. Edi Rama i ka bërë lesh gazetarët e Kosovës duke ua caktuar rolin e palaços (ata që e kanë merituar), i ka fyer thuaja të gjithë politikanët e Kosovës përjashtuar këtu pjesën sijameze të vetes së tij, shumë më inferior në aspektin intelektual, politik e mos të flasim për atë retorik, Shkëlqesinë e Tij, presidentin e Republikës së Turkmenistanit (e kanë të përbashkët mik shpirti, zemre e sidomos interesi, demokracin e përmasave aziatike, Rexhep Hatip Erdoganin), zotëri Hashim Thaçi. Në mënyrën më të paskrupullt i ka quajtur idiotër, mashtrues dhe gënjeshtarë politikanët e Kosovës duke ua shitur rrenën e vet të tjerëve. Edi Ramës dhe Hashim Thaçit nuk iu pëlqet prapica nëse Kosova humb territor përmes korrigjimit të lehtë apo të rëndë të kufijve, ndërrimit të territoreve, tregëtimit me serbët dhe shqiptarët fatkeq që do të shndërrohen në para të imta për pazare të mëdha me Serbinë midis kriminelëve Vuçiq dhe Daçiq dhe donkishotëve milionerë, Edi Rama dhe Hashim Thaçi. Edi Ramës nuk i interesojnë kufijtë e Kosovës sikur as edhe ata të Shqipërisë nëse nuk ka një interes dhe nuk mund t'i përdorë për ta mbajtur pushtetin. I tillë është edhe Hashimi, ky kallamar i ushqyer në hurdat e Erdoganit dhe të Ramës. Shqipëria nuk ka gjasa

të dalë nga ky kaos i organizuar midis dy komuniteteve politike të kriminalizuara e që identifikohen si pozitë demokratike dhe opozitë demokratike. Lul Basha, "gjyshi digjital" dhe Kryemadha mendjvogël nuk janë alternativa e Edi Ramës, sikur që as Edi Rama nuk është mundësia për integrim të Shqipërisë. Lufta politike midis dy krahëve apo poleve politike të kriminalizuara e që udhëhiqen nga të korruptuarit bashkëpunues i ngjanë luftës së mafies për kontrollim të tregut dhe shitjes së substancave narkotike. I vetmi dallim është se të dy baronët, i pari do Edi, për shkak të kontrollit të pushtetit ka mundësi që në treg të nxjerrë kokainën, si më shumë fitimprurëse kurse baroni i opozitës, don Luloja për shkak të rrethanave aktuale nuk ka mundësi të shesë kokainë por, kur i jepet rasti e shet heroinën e në rastin më të keq i promovon prodhimet vendore të Lazaratit, Dibërës apo të Shkodrës. Qoftë edhe figurativisht. Shqipëria ka nevojë për një forcë të re politike e cila nuk është e ngjizur nga banka e spermës politike të dhuruesve Edi Rama dhe Lulzim Basha. Prej "gjyshit digjital", në këtë aspekt nuk ka aspak rrezik për faktin se banka e spermës që e ka deponuar 30 vjet më parë, kur kishte potencë politike është hedhur në mbeturina si material i papërdorshëm dhe i pariciklueshëm! I ka mbetur që kohë pas kohe ta lëshojë ndonjë pordhushë që nuk e shqetëson askënd përveçse vetë trembet nga pordha e tij. I vetmi rrezik është se kontribuon në ndotjen apo kontaminimin e mjedisit politik. Politika në Shqipëri është shndërruar në politikë të fiseve apo familjeve mafioze, në mungesë të një alternative për të cilën Shqipëria dhe shqiptarët kanë nevojë si peshku për ujë apo i humburi në shkretëtirën e Saharasë për një fije flladi. Kemi të drejtë të shpresojmë për këtë alternativë politike sepse, në të kundërtën, ferrit të Dante Aligerit do t'i shtohen edhe disa rrahë të tjerë!

15 maj 2019 Prishtinë

Në vazhdim, Kosova, Maqedonia e Veriut apo vendi i Udhëheqësit të Madh të Popullit shqiptar. Mali i Zi dhe Lugina e Preshevës, nëse në ndërkohë nuk ia bashkon Kosovës, presidenti Thaçi.



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVISIONI I KOSOVO
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

shpall:

KONKURS

Për plotësimin e pozitave të lira të punës

Kryeredaktor në RTK 1-TV, RTK 3-TV dhe RTK Radio

3 pozita

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Planifikon, organizon, mbikëqyrë dhe në bashkëpunim me Drejtorin e RTK TV-së, respektivisht Radios, koordinon tërë procesin e punës në sektorin programor të kanalit televiziv përkatës, respektivisht të Radios, në pajtim me Ligjin e RTK-së, Statutin dhe Kodin etik të gazetarisë në RTK;
- Harton dhe zbaton planin vjetor programor të kanalit televiziv përkatës, respektivisht Radios;
- Përgatitë raporte periodike dhe vjetore lidhur me përmbushjen e planit vjetor programor;
- Zbaton normativat dhe standardet programore;
- Është përgjegjës për përmbajtjen programore të kanalit televiziv përkatës, respektivisht Radios;
- Koordinon punën e redaktorëve përgjegjës, producentëve ekzekutiv dhe nëpërmjet tyre redaktorëve të programeve të kanalit televiziv përkatës, respektivisht Radios;
- Propozon dhe zbaton strategjinë zhvillimore për programet e kanalit televiziv përkatës, respektivisht Radios;
- Projektet për emisione të reja programore, me përqindjen paraprakisht të përcaktuar të shikueshmërisë, ia propozon Drejtorit të RTK TV-së, respektivisht Radios;
- Mbanë përgjegjësinë editoriale të programit, sipas strukturës së programit të përcaktuar me ligj; Bashkëpunon për përgatitjen e planeve për arsimim, aftësim profesional dhe trajnim të stafit programor;
- Mbanë takimet për biseda të rregullta vjetore me bashkëpunëtorët e vet;
- Përgatitë kushtet organizative për aftësim të stafit programor;
- Përcjellë njohuritë profesionale të bashkëpunëtorët;
- Është bashkëpërgjegjës për zhvillim dhe avancim profesional për bashkëpunëtorët.

Kushtet:

- Kualifikim superior profesional;
- Të paktën tri vjet përvojë pune në menaxhim editorial në media;
- Të jetë person me integritet të lartë personal dhe moral;
- Të ketë njohuri të shkëlqyeshme të spektrit medial në Kosovë dhe më gjerë;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në organizim, udhëheqje dhe planifikim;
- Standard të lartë të gjuhës shqipe në të shkruar dhe në të folur;
- Njohje e shkëlqyeshme e gjuhës angleze në të shkruar dhe në të folur;
- Njohje të mirë të gjuhës serbe;
- Njohje të shkëlqyeshme të punës me kompjuter;
- Aftësi për caktimin e prioritetëve dhe për të punuar në mënyrë efikase nën presion;
- Aftësi për të bashkëvepruar me maturi dhe ndjeshmëri me kolegë dhe me palë;
- Të mos ketë dëshmuar përkatësi partiake;
- Përkushtim ndaj transmetuesit publik;

Kandidatët e paraqitur për këto pozita duhet:

- të jenë qytetar të Kosovës, të regjistruar sipas dispozitave ligjore të Republikës së Kosovës;
- të mos kenë qenë të dënuar për ndonjë vepër penale dhe që të mos gjenden aktualisht nën hetime;
- të mos kenë angazhime, biznese, etj. të cilat mund të konsiderohen si konflikt interesi;
- të mos kenë asnjë angazhim tjetër shtesë të punës jashtë këtij vendi të punës;
- të mos jetë tre (3) vitet e fundit në organet e larta udhëheqëse politike.

Formularët për aplikim mund të shkarkohen në adresën e internetit të RTK-së www.rtklive.com. Dokumentacioni përbëhet nga: formularët e plotësuar së bashku me CV-në, dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e ltuara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuar nga MASHT-i), një certifikatë të lindjes, një kopje e letërnjoftimit, dëshminë e përvojës së punës, dy referenca dhe çertifikata që nuk është nën hetime të lëshuar gjatë muajit të fundit para aplikimit.

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet i skenuara, në mënyrë elektronike, përmes internet adresës konkurs@rtklive.com, deri më datë 30.05.2019 në orën 16:00.

Vetëm aplikacionet dhe dokumentet e dorëzuara përmes postës elektronike do të pranohen.

Aplikacioni dhe dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merret në konsiderim.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVISIONI I KOSOVO
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

objavljuje:

KONKURS

Za ova slobodna radna mesta

Glavni i odgovorni urednik RTK 1-TV, RTK 3-TV i RTK Radio

3 pozicije

Zadaci

- Planira, organizuje, nadzire i u saradnji sa direktorom RTK Televizije odnosno Radia, koordinise celokupni proces rada u sektoru programa odgovarajuceg televizijskog kanala odnosno Radia, u skladu sa Zakonom o RTK-u, Statutom i Etičkim novinarskim kodom RTK-a;
- Priprema i sprovodi godišnji plan programa odgovarajuceg televizijskog kanala odnosno Radia;
- Priprema periodične i godišnje izveštaje o realizaciji godišnjeg programskog plana;
- Sprovodi programske normative i standarde;
- Odgovoran/na je za ukupni sadržaj programa odgovarajuceg televizijskog kanala odnosno Radia;
- Koordinise rad odgovornih urednika, izvršnih producenata i preko njih i ostalih urednika svih programa na Televizijama odnosno Radio;
- Predlaže i priprema strategiju razvoja za programe odgovarajuceg televizijskog kanala odnosno Radia;
- Predlaže projekte za nove emisije Direktor RTK Televizije odnosno Radia, sa prethodno definisanim stepenom gledanosti;
- Ima uređivačku odgovornost u pogledu sadržaja programa po programskoj strukturi utvrđenoj zakonom;
- Sarađuje u pripremi planova za obrazovanje, stručno osposobljavanje i obučavanje programskog osoblja;
- Održava sastanke redovnih godišnjih razgovora o proceni rada svojih saradnika;
- Priprema organizacione uslove za obuku programskog osoblja;
- Prenosi svoje profesionalno znanje saradnicima;
- Odgovoran je za razvoj i profesionalno usavršavanje saradnika.

Uslovi

- Visoka stručna sprema;
- Najmanje tri godine uredničkog iskustva u medijima;
- Visok lični i moralni integritet;
- Odlično poznavanje medijske sfere na Kosovu i šire;
- Dokazane veštine u organizovanju, upravljanju i planiranju;
- Negovanje visokog standarda albanskog jezika, usmeno i pismeno;
- Odlično poznavanje engleskog jezika, usmeno i pismeno;
- Dobro poznavanje srpskog jezika;
- Odlično poznavanje rada na računaru;
- Sposobnost određivanja prioriteta i efikasnost u radu pod pritiskom;
- Sposobnost uspostavljanja timskog rada i pažljivost prema kolegama i strankama;
- Nestranačka ličnost;
- Posvećenost javnom emitovanju.

Zainteresovani kandidati za ove pozicije treba:

- da su državljanin Kosova, registrovani pod zakonskim odredbama Republike Kosovo;
- da nisu osuđivani za krivična dela i da trenutno nisu pod istragom;
- da nemaju preuzete obaveze, biznise, itd., sve što se može smatrati sukobom interesa sa pozicijom za koju konkurišu;
- da ne budu dodatno radno angažovani izvan ovog radnog mesta;
- da u poslednje tri (3) godine nisu bili u višim organima političkog rukovodstva.

Formular za prijavu se može preuzeti na internet strani www.rtklive.com. Dokumentaciju čine: popunjeni formular sa CV-ijem, dokaz o obrazovanju i profesionalnim kvalifikacijama (inostrane diplome trebaju biti nostrifikovane u Ministarstvu Obrazovanja Kosova), izvod iz matične knjige rođenih, kopija Lične Karte, dokaz o radnom iskustvu, dve preporuke i uverenje da nisu pod istragom (ne starije od mesec dana od dana apliciranja).

Kompletna dokumentacija se u elektronskom formatu, skenirana, šalje na email adresu: konkurs@rtklive.com, do 30.05.2019, do 16:00 sati.

Prihvataju se samo prijave i dokumentacija predati elektronskim putem.

Nepotpuna dokumentacija i prijave neće biti razmatrane.

Za kandidate koji uđu u uži izbor organizuje se pismeni test i intervju.



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVISIONI I KOSOVO
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

shpall:

KONKURS

Për plotësimin e pozitës së lirë të punës

Kryeredaktor në RTK 2-TV

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Planifikon, organizon, mbikëqyr dhe, në bashkëpunim me Drejtorin e RTK 2-TV-së, koordinon tërë procesin e punës në sektorin programor të RTK 2-TV-së, në pajtim me Ligjin e RTK-së, Statutin dhe Kodin etik të gazetarisë në RTK;
- Harton dhe zbaton planin vjetor programor të RTK 2-TV-së;
- Përgatit raporte periodike dhe vjetore lidhur me përmbushjen e planit vjetor programor;
- Zbaton normativat dhe standardet programore;
- Është përgjegjës për tërë përmbajtjen programore në RTK 2-TV;
- Koordinon punën e redaktorëve përgjegjës dhe nëpërmjet tyre redaktorëve në të gjitha programet e RTK 2-TV-së;
- Propozon dhe zbaton strategjinë zhvillimore për programin e RTK 2-TV-së;
- Projektet për emisione të reja programore, me përqindjen paraprakisht të përcaktuar të shikueshmërisë, ia propozon Drejtorit të RTK 2-TV-së;
- Mban përgjegjësinë editoriale të programit, sipas strukturës së programit të përcaktuar me ligj;
- Bashkëpunon për përgatitjen e planeve për arsimim, aftësim profesional dhe trajnim të stafit programor;
- Mban takimet për biseda të rregullta vjetore me bashkëpunëtorët e vet;
- Përgatit kushtet organizative për aftësim të stafit programor;
- Përcjell njohuritë profesionale të bashkëpunëtorët;
- Është bashkëpërgjegjës për zhvillim dhe avancim profesional për bashkëpunëtorët.

Kushtet:

- Kualifikim superior profesional;
- Të paktën tri vjet përvojë pune në menaxhim editorial në media;
- Të jetë person me integritet të lartë personal dhe moral;
- Të ketë njohuri të shkëlqyeshme të spektrit medial në Kosovë dhe në gjuhë;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në organizim, udhëheqje dhe planifikim;
- Standard të lartë të gjuhës serbe në të shkruar dhe në të folur;
- Njohje e shkëlqyeshme e gjuhës angleze në të shkruar dhe në të folur;
- Njohje të mirë të gjuhës shqipe;
- Njohje të shkëlqyeshme të punës me kompjuter;
- Aftësi për caktimin e prioritetëve dhe për të punuar në mënyrë efektive nën presion;
- Aftësi për të bashkëpunuar me maturi dhe ndjeshmëri me kolegë dhe me palë;
- Të mos ketë dëshmuar përkatësi partiake;
- Përkushtim ndaj transmetuesit publik;

Kandidatët e paraqitur për këtë pozitë duhet:

- të jenë qytetar të Kosovës, të regjistruar sipas dispozitave ligjore të Republikës së Kosovës;
- të mos kenë qenë të dënuar për ndonjë veçer penale dhe që të mos gjenden aktualisht nën hetim;
- të mos kenë angazhime, biznese, etj. të cilat mund të konsiderohen si konflikt interesi;
- të mos kenë asnjë angazhim tjetër shtesë të punës jashtë këtij vendi të punës;
- të mos jetë tre (3) vitet e fundit në organet e larta udhëheqëse politike.

Formularët për aplikim mund të shkarkohen në adresën e internetit të RTK-së www.rtklive.com. Dokumentacioni përbëhet nga: formularët e plotësuar së bashku me CV-në, dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i), një certifikatë të lindjes, një kopje e letërnjoftimit, dëshminë e përvojës së punës, dy referenca dhe certifikata që nuk është nën hetim të lëshuar gjatë muajit të fundit para aplikimit.

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet i skenuara, në mënyrë elektronike, përmes internet adresës konkurs@rtklive.com, deri më datë 30.05.2019 në orën 16:00.

Vetëm aplikacionet dhe dokumentet e dorëzuara përmes postës elektronike do të pranohen.

Aplikacioni dhe dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merrret në konsiderim.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVISIONI I KOSOVO
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

objavljuje:

KONKURS

Za slobodno radno mesto

Glavni i odgovorni urednik RTK 2-TV

Zadaci

- Planira, organizuje, nadzire i u saradnji sa direktorom RTK 2-TV, koordinise celokupni proces rada u sektoru programa RTK 2-TV, u skladu sa Zakonom o RTK-u, Statutom i Etičkim novinarskim kodom RTK-a;
- Priprema i sprovodi godišnji plan programa na RTK 2-TV;
- Priprema periodične i godišnje izveštaje o realizaciji godišnjeg programskog plana;
- Sprovodi programske normative i standarde;
- Odgovoran/na je za ukupni sadržaj programa na RTK 2-TV;
- Koordinise rad odgovornih urednika, izvršnih producenata i preko njih i ostalih urednika svih programa na RTK 2-TV;
- Predlaže i priprema strategiju razvoja za programe RTK 2-TV;
- Predlaže projekte za nove emisije Direktor RTK 2-TV, sa prethodno definisanim stepenom gledanosti;
- Ima uređivačku odgovornost u pogledu sadržaja programa po programskoj strukturi utvrđenoj zakonom;
- Saraduje u pripremi planova za obrazovanje, stručno osposobljavanje i obučavanje programskog osoblja;
- Održava sastanke redovnih godišnjih razgovora o proceni rada svojih saradnika;
- Priprema organizacione uslove za obuku programskog osoblja;
- Prenosi svoje profesionalno znanje saradnicima;
- Odgovoran je za razvoj i profesionalno usavršavanje saradnika.

Uslovi

- Visoka stručna sprema;
- Najmanje tri godine uredničkog iskustva u medijima;
- Visok lični i moralni integritet;
- Odlično poznavanje medijske sfere na Kosovu i šire;
- Dokazane veštine u organizovanju, upravljanju i planiranju;
- Negovanje visokog standarda srpskog jezika, usmeno i pismeno;
- Odlično poznavanje engleskog jezika, usmeno i pismeno;
- Dobro poznavanje albanskog jezika;
- Odlično poznavanje rada na računaru;
- Sposobnost određivanja prioriteta i efikasnost u radu pod pritiskom;
- Sposobnost uspostavljanja timskog rada i pažljivost prema kolegama i strankama;
- Nestranačka ličnost;
- Posvećenost javnom emitovanju.

Zainteresovani kandidati za ovu poziciju treba:

- da su državljani Kosova, registrovani pod zakonskim odredbama Republike Kosovo;
- da nisu osuđivani za krivična dela i da trenutno nisu pod istragom;
- da nemaju preuzete obaveze, biznise, itd., sve što se može smatrati sukobom interesa sa pozicijom za koju konkurišu;
- da ne budu dodatno radno angažovani izvan ovog radnog mesta;
- da u poslednje tri (3) godine nisu bili u višim organima političkog rukovodstva.

Formular za prijavu se može preuzeti na internet strani www.rtklive.com. Dokumentaciju čine: popunjeni formular sa CV-ijem, dokaz o obrazovanju i profesionalnim kvalifikacijama (inostrane diplome trebaju biti nostrifikovane u Ministarstvu Obrazovanja Kosova), izvod iz matične knjige rođenih, kopija Lične Karte, dokaz o radnom iskustvu, dve preporuke i uverenje da nisu pod istragom (ne starije od mesec dana od dana apliciranja).

Kompletna dokumentacija se u elektronskom formatu, skenirana, šalje na email adresu: konkurs@rtklive.com, do 30.05.2019, do 16:00 sati.

Prihvataju se samo prijave i dokumentacija predati elektronskim putem.

Nepotpuna dokumentacija i prijave neće biti razmatrane.

Za kandidate koji uđu u uži izbor organizuje se pismeni test i intervju.

E rrallë

Bretkosa gjendet në kutinë e bananeve në supermarket

Një bretkosë nga Kosta Rika është gjetur në një kuti bananesh në Nottingham. Bretkosa u gjet më shumë se 8.500 kilometra larg shtëpisë së saj në një supermarket në Britani. Punonjësit që e zbuluan në kutinë e bananeve e quajtën bretkosën Lloyd.



FOTO E DITES



Pamje e një pjese të autostradës "Arbën Xhaferi" e cila do të përrurohet më 29 maj.
/Foto: ER/

BARSOLETA E DITËS



Polici: Mirëmbërma! Ku po shkoni? Shoferi: Pse pyetni? Do të vini në shtëpinë tonë a?!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

"DUMBO" 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton



Ne ora 16:00 dhe 19:00

"AVENGERS; Endgame"

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

"EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"

Krim/Mister; 1 ore 48 min

Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger



E jashtëzakonshme

'Çmendën' kafedashësit, paguajnë 75 dollarë për një filxhan

Një zinxhir lokalesh në jug të Kalifornisë ka thyer rekord duke çuar çmimin në 75 dollarë për një filxhan kafe. "Klatch Coffee Roasters", që ndodhet në Los Anxhelos dhe San Francisko, e shet aktualisht një kafe me çmim kaq të lartë. Kjo ka ardhur si "bombë" për personat që konsumojnë vazhdimisht kafe, të cilët e blejnë një filxhan



Starbucks për gjashtë dollarë. Ka një arsye përse kafeja është kaq e shtrenjtë. Klatch është i vetmi në Shtetet e Bashkuara që shet kafe "Elita Geisha" e cila është në sasi të limituar.



16.05.2019

"THE HUSTLE"

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Detyrimet e ditës nuk ju lënë të mendoni për


t'i shijuar ato orët e qeta që mund të keni. Një çështje që qëndron pezull nuk po ju ndahet.



DEMI

Nuk është se do të keni ndonjë gjë të rëndë-

sishme për të bërë sot. Rutina e ditës do të bëjë çdo gjë të venitet dhe ta humbni interesin tuaj.



BINJAKËT

Çdo provokimi, goftë edhe i vogël, ju do

t'i përgjigjeni me mjaft agresivitet. Nuk do të tentojë askush të bëjë negociata sot me ju.



GAFORRJA

Jeni i pasigurt në shumë

hapa që po merrni sot. Kjo lloj pasigurie buron edhe nga arsyeja që akoma nuk dini se çdo të bëhet nga ana financiare.



LUANI

Epiqendra e ditës sot është

familja me të mirat dhe debatet brenda saj që ju do të dini t'i shuani me kalimin e orëve dhe do ta qetësoni këdo.



IRGJËRËSHA

Po prisni të merrni frytet e

marrëveshjeve tuaja të vjetra që mendoni që ka ardhur momenti për t'i nxjerrë nga harresa.



PESHORJA

Ngushëllimi i ditës së sotme do të jetë vetëm

puna. Doni ta hiqni mendjen nga një situatë stresuese dhe po i përkushtoheni punës.



AKREPI

Ndjenja dhe pasioni janë një

ndërthurje e rrezikshme sot. Do të kujtoheni për këtë gjë sapo partneri të marrë në konsideratë një zhvillim në lidhjen tuaj.



SHIGJETARI

Pas disa debateve në lidhjen tuaj sot

mendohej se nuk do të ishit me humor të mirë. Por, kjo gjë vetëm ka hedhur pak kripë që ka lezetuar marrëdhënien.



BRICJAPI

Shumë energji i dedikohet çdo veprimi

që bëni dhe ju jeni prej atyre që shikoni edhe hollësitë. Në shumë raste ky vëzhgim ju ka ndihmuar.



UJORI

Për ta balancuar ditën ju duhet një

mirëkuptim midis detyrës dhe ndjenjës dhe këtë do ta arrini falë pranisë së planetëve në shenjën tuaj.



PESHQIT

Sekreti juaj i mirëqenies fizike

dhe psikologjike është prania e njerëzve të dashur. Gjithmonë keni dikë me të të bisedoni.

Ndahet çifti i njohur



Jesse Lee Soffer dhe Torrey DeVitto janë ndarë. Jesse dhe Torrey filluan të takoheshin verën e kaluar, por "Us Weekly" raporton se ata tashmë janë ndarë.

"Ata janë ende miq, por janë ndarë", ka thënë një burim i afërt me ta. Torrey ka fshirë fotografitë e udhëtimit të saj në Skoci nga llogaria e saj në "Instagram".

Cardi B del për të blerë e veshur vetëm me mantel hoteli



Cardi B ka shije për rroba shumë të shtrenjta, por duket se asaj nuk i pëlqen të vishet bukur kur del për t'i blerë ato. Reperja 26-vjeçare ka shfrytëzuar kohën e lirë nga udhëtimi i saj në Miami ku është paraqitur në

Festivalin e Muzikës Rolling Loud për të blerë në një nga qendrat më të njohura tregtare. Duket se Cardi B menjëherë sapo u zgjua, pas një natë të gjatë që kaloi në klubin e natës "Liv", ka dalë për të blerë me mantel të hotelit dhe një palë papuçe.



Rita Ora, me veshje seksi në darkën me Liam Payne

Rita Ora është një "Poster Girl", të paktën bazuar në veshjen e saj seksi në formë rrjete nga marka e njohur britanike "Poster Girl", të cilën ajo e kishte veshur gjatë një darke me Liam Payne dhe kryeredaktorin e "Vogue"-s

në Britani, Edward Enniful. Ylli i muzikës pop kishte shijuar darkën me miqtë në një lokal të njohur në Londër derisa kishte veshur një bluzë me tre rripa të hollë dhe një fustan të gjatë, të dyja nga kjo markë e veshjeve.

Wendy Williams thotë se del shumë shpesh në takime dashurie



Wendy Williams është beqare dhe gati për lidhje dashurie. Prezantuesja televizive ka folur për divorcin nga ish-bashkëshorti i saj Kevin Hunter duke thënë se është gati që të ecë përpara, ndonëse nuk e ka gjetur ende dashurinë. "Jam duke e rimarrë timo-

nin e jetës sime. Nuk kam të dashur, por jam duke e rizbuluar dashurinë. Dal në takime dashurie, madje dal bukur shpesh", ka thënë Williamsi në një intervistë së fundmi. Ajo ka thënë se shumë nga meshkujt që ajo i ka pjesë të stafit e kanë vizituar atë në 'strehën e saj të beqarisë' në Nju Jork.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045 82 82 82

Fitojnë Feronikeli dhe Prishtina, titulli vendoset të dielën



PRISHTINË, 15 MAJ - Dy skuadrat kryesuese, Feronikeli dhe Prishtina, kanë shënuar fitore të mërkurën ndaj Llapit, përkatësisht Trepçës '89 dhe në këtë mënyrë titulli i kampionit do të vendoset në ndeshjen e fundit që zhvillohet në Drenas në mes të këtyre dy skuadrave. Të mërkurën fitores i është gëzuar edhe Flamurtari, kurse Drenica dhe Ballkani kanë ndarë pikët. Dy ndeshjet e fundit të javës së parafundit zhvillohen sot (e enjte). Takohen Gjilani-Liria dhe KEK-u-Ferizaj.

Llapi - Feronikeli 1-3

Llapi pas humbjes në xhiron e kaluar nga Prishtina, të mërkurën si vendës u mposht edhe nga Feronikeli dhe në këtë mënyrë mbetet jashtë garës për titull të kampionit. Në anën tjetër, Feronikeli me tri pikët e fituara është edhe më afër titullit të kampionit dhe për të arritur një gjë të tillë i mjafton vetëm barazimi ndaj Prishtinës. Në minutën e 18 mysafirët shënuan golin e parë. Yll Hoxha asistoi për mrekulli për Arbër Prekazin që me kokë shënoi për 0-1. Dy minuta më vonë Llapi u rikthye në lojë, pasi Festim Alidema shënoi nga penalltia për 1-1. Në pjesën e dytë Feronikeli ishte skuadër më e mirë dhe realizoi edhe dy gola të tjerë. Fillimisht shënoi Mendurim Hoti (55), kurse më pas edhe Kastriot Rexha (63), për ta vendosur rezultatin final 1-3.

Prishtina - Trepça '89 3-0

Prishtina nuk ka lejuar befasi dhe e ka mposhtur skuadrën e Trepçës '89 (3-0).

Pjesa e parë në kryeqytet nuk solli gola, por në fillim të pjesës së dytë Mankenda realizoi për 1-0. Në minutën e 67 Basit Khalid e dyfishoi epërsinë e vendësve, ndërsa në minutën e tretë shtesë Mario Morina e vulosi rezultatin final 3-0. Pas kësaj fitore, Prishtina është e dyta në tabelë me dy pikë më pak se Feronikeli dhe në ndeshjen e fundit i duhet fitorja nëse dëshiron të shpallet kampion. Në anën tjetër, '89-shi do të ketë punë për ta siguruar mbetjen në Superligë, kurse kjo skuadër renditet në pozitën e nëntë me 39 pikë.

Drita - Flamurtari 1-2

Flamurtari e ka mposhtur kampionen aktuale, Dritën (1-2). Vendësit shënuan të parët në minutën e 20. Autor i golit ishte Klajdi Burba. Flamurtari e kërkoi golin e barazimit, por e arriti vetëm në minutën e 60, kurse shënoi Shend Kelmendi. Njëmbëdhjetë minuta më pas Agron Bruqi shënoi golin që në fund u solli kuqezinjve tri pikë të arta në garën për mbijetesë. Tash Flamurtari pozicionohet në vendin e pestë me 42 pikë, derisa Drita është një pozitë më lart me 48 pikë. Në xhiron e fundit, Drita i shkon Ballkanit në Suharekë, kurse Flamurtari e pret Llapin.

Drenica - Ballkani 1-1

Drenica - Ballkani ishte ndeshja e vetme që të mërkurën nuk solli fitues, pasi përfundoi me rezultat 1-1. Kuqezinjtë nga Skenderaj kaluan në epërsi me golin e Hysen Tahirit në minutën e 41-të.

IPKO SUPERLIGA

Llapi - Feronikeli	1-3
Prishtina - Trepça '89	3-0
Drita - Flamurtari	1-2
Drenica - Ballkani	1-1

Të enjten takohen:

Gjilani - Liria
KEK-u - Ferizaj

TABELA

		PIKË
1. Feronikeli	32	77
2. Prishtina	31	75
3. Llapi	31	69
4. Drita	31	48
5. Flamurtari	31	42
6. Ferizaj	31	40
7. Drenica	31	40
8. Ballkani	31	40
9. Trepça '89	31	39
10. Gjilani	31	35
11. Liria	31	28
12. KEK-u	31	1

Në xhiron e radhës takohen: Ferizaj-Gjilani, Trepça '89-KEK-u, Feronikeli-Prishtina, Flamurtari-Llapi, Ballkani-Drita, Liria-Drenica.

LIGA E PARË

Besa - Arbëria	7-2
Vushtrria - Ramiz Sadiku	3-1
Trepça - Kika	1-0
Istogu - Vëllaznimi	2-1
Drenasi - Fushë Kosova	1-1
Vitia - Vllaznia (P)	0-1
2 Korriku - Dukagjini	2-1
Bashkimi (K) - Onix	3-1

TABELA

		PIKË
1. Vushtrria	29	63
2. Besa	29	58
3. Dukagjini	29	59
4. Vëllaznimi	29	54
5. Vitia	29	47
6. Trepça	29	38
7. Istogu	29	38
8. Onix	29	37
9. Fushë Kosova	29	35
10. 2 Korriku	29	35
11. Arbëria	29	34
12. Drenasi	29	33
13. Vllaznia	29	31
14. Ramiz Sadiku	29	30
15. Kika	29	29
16. Bashkimi (K)	29	29

Ballkani e barazoi rezultatin pas një ore lojë, kurse pasimin e Blendi Baftiut në gol e konkretizoi Jetmir Topalli. Për këtë të fundit ishte goli i dhjetë në këtë kampionat. Këto dy klube ndajnë edhe pozitën 7-8 me nga 40 pikë të grumbulluara.

SHKURT

Me vendim të FFK-së pushohen të gjitha komisionet dhe shoqatat

Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës mori vendim që ta pushojë mandatin dhe punën e të gjitha komisioneve dhe shoqatave. Sipas njoftimit të FFK-së, do të bëhet riformatizimi i të gjitha komisioneve dhe shoqatave. "KE ka marrë vendim që pas përfundimit të garave të këtij edicioni ta pushojë mandatin dhe punën e të gjitha komisioneve dhe shoqatave dhe do ta bëjë riformatizimin e tyre para edicionit të ri të garave me qëllim të profesionalizimit të këtyre komisioneve dhe shoqatave në përputhje me kërkesat e kohës dhe në të mirë të futbollit të Kosovës. KE shqyrtoi edhe kërkesat dhe parashtrës drejtuar këtij organi", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Napoli nxjerr në shitje Hysajn

Në Itali e bëjnë fakt të kryer. Elseid Hysaj po përgatit tashmë largimin në fund të këtij sezoni, e me shumë gjasë është në listën e shitjeve të skuadrës së Napolit. E gjithë kjo për shkak të një prapaskene. Sipas "Gazzetta dello Sport", mbrojtësi i kombëtares shqiptare nuk ka pranuar që të jetë zëvendësues në skuadër, ndaj ka ardhur ky vendim për largimin e tij. Deri më tani dy janë pistat që shtrohen për të ardhmen e mbrojtësit kuqezij: Roma dhe Interi, ekupe që kanë shprehur me kohë dëshirën për t'i pasur shërbimet e shkodoranit.

Pogba, shumë afër të bëhet 'galaktik'

Kontrata e 26-vjeçarit Paul Pogba kushton mbi 150 milionë paund, një shumë që do të trembte çdo klub. Por ky nuk është rasti i Real Madridit që shpeshherë ka treguar se paratë nuk janë problem. Mediat angleze raportojnë se "galaktikët" kanë filluar kontaktet e në verë pritet të ndodhë transferimi. Real Madridi ka bërë një lëvizje për Paul Pogban, e tashmë ndërmjetësit po diskutojnë një marrëveshje të mundshme për yllin e Manchester Unitedit. 26-vjeçari në mënyrë aktive dëshiron të largohet për "Bernabeu" në verë dhe është një nga objektivat kryesore nga trajneri Zinedine Zidane.

Woodsi ëndërron pjesëmarrjen në Olimpiadë

CYPRUS, 15 MAJ - Legjenda e sportit të golfit, Tiger Woods, tashmë 43-vjeçar, ka deklaruar se ka një ëndërr në sirtar: Të luajë në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020". Golfi u rikthye si sport olimpik në "Rio 2016" pas 112 vjetësh. Në olimpiadën japoneze kualifikohen 60 golfistë dhe

Woods synon të jetë pjesëmarrës. "Nuk kam marrë pjesë kurrë në një olimpiadë dhe në moshën time nuk besoj se do të kem shumë mundësi për ta realizuar këtë gjë në të ardhmen. Ndaj, do të ishte nder të isha pjesë e ekipit amerikan që do të shkoj aty", ka deklaruar Tiger Woods.

Më tej, fituesi i 15 titujve Major ka shtuar: "E di që kualifikimi është i vështirë. Duhet ta sistemoj kalendarin tim të garave për të luajtur në kualifikueset olimpikë. Nëse luaj mirë në ngjarjet e mëdha, mund t'ia dal mbanë të kualifikohem". Pas turneut Masters të Augusta,

ku triumfoi një muaj më parë, Woods ndodhet në vendin e gjashtë të renditjes botërore. Automatikisht kualifikohen 15 vendet e para të renditjes botërore deri më 22 qershor 2020. Çdo shtet mund t'i kualifikojë në maksimum katër sportistë.



Rreth 1.7 milion euro investime për sportin në Gjakovë

PRISHTINË, 15 MAJ - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, priti të mërkurën në takim kryetarin e Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini. Në këtë takim, ministri Gashi dhe kryetari Gjini kanë nënshkruar dy memorandume bashkëpunimi për mbështetje financiare për projektet "Renovimi i Stadiumit të Qytetit në Gjakovë" dhe "Ndërtimi i kompleksit të tenisit në Komunën e Gjakovës". Memorandumi për 'Renovimin e Stadiumit të Qytetit në Gjakovë' do të implementohet gjatë viteve 2019/2020/2021, kurse MKRS-ja për këtë memorandum bashkëpunimi investon mjetet financiare në vlerë prej 1,300,000.00, ndërsa memorandumi për 'Ndërtimin e kompleksit të tenisit në Komunën e Gjakovës' do të implementohet gjatë vitit 2019. Ky investim mbështetet me mjetet financiare në vlerë prej 383,000.00, thuhet në njoftimin e MKRS-së. Ministri Gashi ka thënë se nënshkrimi i këtyre memorandumeve për investime në fushën e sportit




në Komunën e Gjakovës po bëhet me qëllim të krijimit dhe avancimit të infrastrukturës sportive. "Pas këtyre investimeve të rinj të Gjakovës dhe sportistëve të këtij qyteti do të kenë mundësi më të mira për realizimin e aktiviteteve të tyre sportive. Ne si Ministri e Sportit mbetemi të përkushtuar që të bashkëpunojmë ngushtë me të gjitha komunat e Kosovës dhe t'i ndihmojmë ato për përmirësimin

e infrastrukturës sportive, sepse kështu krijohen mundësi dhe kushte të volitshme për zhvillimin e aktiviteteve sportive", ka thënë ministri Gashi. Ndërkaq kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini, shprehu falënderim të veçantë për ministrin Gashi për nënshkrimin e këtyre memorandumeve, duke e konsideruar këtë veprim të ministrit të shumëpritur për qytetarët e Gjakovës.

Golden State fiton finalen e parë ndaj Portlandit

OAKLAND, 15 MAJ - Golden State Warriors, edhe pse nuk kishte Kevin Durantin, e ka nisur mbarë serinë e finaleve në Konferencën e Perëndimit. Kampionët në fuqi mposhtën në ndeshjen e parë Portland Trail Blazersin. Shifrat e takimit ishin 116-96 dhe Warriorsi pati epërsi të lehtë në dy periodat e para dhe krijoi një diferencë prej nëntë pikësh. Blazersi reagoi në periodën e tretë dhe i ngushtoi shifrat, por më pas vendësit shpërthyen dhe realizuan 16 pikë më shumë në periodën e katërt. Stephen Curry ishte fenomenal (36 pikë, 7 asistime, 6 rebounde), duke arritur të realizojë me sukses nëntë realizime për trepikësh. Hera e dytë që e bën diçka të tillë në "play-off". Në të shkuarën e kanë bërë Klay Thompson dhe Ray Allen. Ndërkohë, Thompsoni ishte protagonist me paraqitjen e tij edhe në fitoren ndaj Blazerz, pasi arriti të shënonte 26 pikë. Draymond Green u ndal në 10 pikë, por në tabelë ishte "mbreti" i skuadrës së



tij me 10 topa të rikuperuar. Damian Lillard në krahun tjetër shënoi 19 pikë, ndërkohë që

spikati Enes Kanter me 16 topat e rikuperuar në tabelë dhe 10 pikët e realizuara.

FINALJA E KONFERENCËS SË PERËNDIMIT

Golden State W. - Portland Trail B. 116-94 (1-0)

SHKURT

Guardiola, trajneri i vitit në Premierë Ligë

Pep Guardiola është shpallur trajneri i vitit në Premierë Ligë pas sezonit impresionues me Manchester Cityn, duke arritur ta mbrojë titullin e kampionit. "Është një nder për mua ta fitoj këtë titull, por meritat shkojnë për të gjithë skuadrën, lojtarët dhe stafin. Faleminderit nga të gjithë ju", ka thënë Guardiola. Trajneri spanjoll është bërë trajneri i parë pas Sir Alex Ferguson që e fiton dy herë radhazi këtë çmim, ndërsa legjenda e Manchester Unitedit e bëri të njëjtën gjë në vitin 2007, 2008 dhe 2009.

Griezmanni konfirmon largimin nga Atletico Madridi

Antoine Griezmann ka vendosur përfundimisht të largohet nga Atletico Madridi në fund të sezonit dhe vendimin e tij ua ka bërë me dije fillimisht drejtuesve të klubit dhe më pas tifozëve madrilenë nëpërmjet një video-mesazhi të shpërndarë në rrjetet sociale. Ndërsa së fundi kishte rinovuar kontratën deri në vitin 2023, Griezmanni duket se dëshiron të provojë një tjetër aventurë dhe ka vendosur të largohet, ndërsa klauzola për prishjen e kontratës së tij është 125 milionë euro. "Pasi fola me klubin, dua të flas edhe me ju, për ta ndarë vendimin tim për t'u larguar. Ky është klubi ku kam fituar trofetë e parë dhe kam ndjerë thajse gjithmonë afeksinin tuaj. Kam kaluar pesë vjet të mrekullueshme këtu dhe do t'ju mbaj gjithmonë në zemër, por tani kam nevojë për të tjera sfida", ka thënë Griezmann.

Sane larg Cityt, afër Bayernit

Leroy Sane mund të largohet nga skuadra e Manchester Cityt gjatë kësaj vere për t'u kthyer në Bundesligë. Mediumet angleze kanë raportuar se Bayern Munchen tashmë ka nisur negociatat me Manchester Cityn në lidhje me transferimin e Sanes. Ky i fundit ka refuzuar rinovimin e kontratës me Cityn që i skadon në vitin 2021 dhe për këtë arsye pritet të largohet nga ekipi. Sane shihet te Bayerni si përforsim i duhur dhe zëvendësim për Franck Riberyn. Sane 23-vjeçar këtë edicion ka shënuar 16 gola dhe ka asistuar 18 herë në 46 paraqitje në të gjitha garat. Kartoni i tij vlerësohet rreth 100 milionë euro.

Jamesi mund të transferohet nga PSG-ja

Anëtori kolumbian James Rodriguez po kërkohet nga kampionët e Ligës 1, Paris Saint-Germain. 27-vjeçari në fund të këtij sezoni përmbyll huazimin dyvjeçar te Bayern Munchen dhe skuadra gjermane tashmë ka vendosur të mos aktivizojë opsionin për blerjen e kartonit të tij. Andaj një kalim në Francë te PSG-ja duket shumë i mundshëm pas hapjes së afatit kalimtar veror.

Marchisio: De Rossi e kishte në zemër vetëm Romën

Daniele De Rossi bëri publik vendimin se do ta luajë ndeshjen e tij të fundit me Romën. Mesfushori veshi për 18 vjet fanellën e kryeqytetasve dhe tashmë rrugët mes palëve do të ndahen. Gjithë bota e futbollit ka dërguar mesazhe për numrin 16 të Romës, ku ndër më të spikaturit ishte ai i Claudio Marchisio, i cili zbulon edhe një prapaskenë në intervistën e tij për "Tuttosport". "E admiroj shumë sepse qëndrimi për një kohë të gjatë në të njëjtin vend nuk është i lehtë. Kur ishte Conte trajner, bashkë me Chiellinin dhe Buffonin jemi munduar ta bindim të vinte te Juventus gjatë kohës që grumbulloheshin në kombëtare. Nuk funksionoj, ai kishte në zemër vetëm Romën", u shpreh Marchisio.



		Autor: GAZMEND MORINA	KËNGËTARJA JONË NË FOTO	THESAR (Lat.)	GREMINË, HUMNERË	KRYEQYTETI I KANADASË	ELEMENT KIMIK	PËRSHTATJE	EPOKA E RE	BASHKËT.	ARKIVOLI	PRINC ARAB (shq.)	TONI ADAMS
	KUMBIMI, USHTIMA								VEND I PAVARUR ANA FARIS				
	POEZIA E DASHURISË									GURRA TINGULLIMITIM			
	FRIKË PATOLOGJIKE NGA VDEKJA												SFOND SHKRONJASH
	ABEDIN REXHA				VOICE OF MARTYRS FRIKË E MADHE					BOKSIERI ... SEFERI			
	BASHKËT.			PIKTURË NË DËRRASË PERANDOR ROMAK						PEZMATIM I VESHIT MURGU I VETMUAR			
	NJËRA NGA SIPËRFAQET KUFIZUESE TË NJË SENDI					ZANORE	AKTORJA HOLLIVUDIANE ... MOORE					ZANORE KRYEQYTETI I JORDANISË (pashq.)	
	KAFSHË GJITARE SHTËPIAKE (shq.)						IRIDIUM, AMPER E KURORËZUAR				ALUMIN ISMET TOTO		
EPOKA E RE	AKTORJA BUDAKOVA	KËNGËTARE E JONA	ARKIVI I FILMAVE	BABAIT	BASHKËT.	MORI, HEJ (pashq.)			PËRHAPJA E VALËVE KLUB FUTBOLLI ITALIAN (shqip.)				
	VARR I NJË SHENJTORI MYSLIMAN									MOTAR NOTË MUZIKORE			
	ALBANOLOGIA DURHAM				KOD I TELEFONIT MOBIL VIGAN, KOLOS				EMËR MASHKULLI TURK PASI (Sport)			BASHKËT. TREVISO	PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT
	USHQEVA FOSHNJËN						LIBËR FILLESTAR	KUSARET BASHKËT.					BASHKËT. EKZISTOJ
	AI QË ZOTËRON NJË PASURI A DIÇKA TJETËR					PJESËTAR I NJË FISË ILIR ZANORE			ISLANDA SHKRONJA XVI	HEROI ... KUKA	"JEMENI" EMËR I VJETËR PËR EGJIPTIN		
